
INSTITUTI I
INTEGRIMIT TË
ISH PËRDIJEKURVE
POLITIKË
RAPORTI VJETOR
2025
Më kujtesë, më drejtësi, më integrim

HYRJE

Instituti i Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP) është një institucion publik i themeluar nga shteti shqiptar, që vepron nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me misionin për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të nxitur integrimin social, ekonomik dhe komunitar të ish-të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre. Instituti e orienton veprimtarinë e tij drejt adresimit të nevojave konkrete të kësaj kategorie, duke marrë në konsideratë moshën e avancuar të një pjese të madhe të përfituesve, problemet shëndetësore, vështirësitë ekonomike dhe pasojat afatgjata të përjashtimit social.

Në qendër të ndërhyrjeve të IIPP qëndron ofrimi dhe koordinimi i ndihmës ekonomike dhe sociale, si një mjet i domosdoshëm për garantimin e një jete dinjitoze për ish-të përndjekurit politikë. Instituti kontribuon në përmirësimin e skemave mbështetëse financiare, në lehtësimin e aksesit në shërbime sociale dhe shëndetësore, si dhe në identifikimin e nevojave emergjente të familjeve që ndodhen në kushte të theksuara varfërie dhe pasigurie sociale. Në këtë kuadër, IIPP mbështet dhe promovon iniciativa që synojnë zbutjen e pasojave ekonomike të përndjekjes, përfshirë mbështetjen për ushqim, higjienë, kujdes shëndetësor bazë dhe mirëqenie sociale.

Paralelisht me ndihmën direkte, IIPP zhvillon dhe mbështet programe dhe projekte për integrimin social dhe ekonomik, me fokus në fuqizimin e individëve dhe familjeve të ish-të përndjekurve politikë. Këto nisma përfshijnë programe të përfshirjes në tregun e punës, trajnime profesionale, nisma për vetëpunësim, si dhe aktivitete që nxisin pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore dhe komunitare. Një vëmendje e veçantë i kushtohet brezave pasardhës, me synim thyerjen e ciklit të përjashtimit social dhe krijimin e mundësive të barabarta për edukim dhe zhvillim.

Në dimensionin kulturor dhe psikosocial, Instituti mbështet projekte të kujtesës historike dhe rehabilitimit shoqëror, të realizuara në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile që përfaqësojnë ish-të përndjekurit politikë. Këto projekte synojnë rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur, forcimin e identitetit dhe ndërtimin e dialogut ndërbrezor, duke kontribuar në proceset e pajtimit shoqëror dhe ndërgjegjësimit publik mbi pasojat e diktaturës.

Në përputhje me misionin e tij, IIPP vepron si një pikë referimi institucionale për koordinimin e politikave sociale dhe të projekteve të integrimit, duke synuar një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj ish-të përndjekurve politikë. Përmes këtyre ndërhyrjeve, Instituti kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më solidare, ku mbështetja sociale dhe integrimi i plotë i viktimave të persekutimit politik konsiderohen si përgjegjësi thelbësore të shtetit dhe shoqërisë.

MISIONI I INSTITUTIT INTEGRIMIT PËRNDJEKURVE POLITIKË

Institutit Integrimit Përndjekurve Politikë ka si mision përpunimin dhe trajtimin e çështjeve themelore që kanë të bëjnë me shtresën e ish të përndjekurve politikë në Shqipëri si dhe harton programe dhe zhvillon politikat e integrimit në jëten e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë të regjimit komunist.

Misioni i Sektorit të Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve:

Trajtimi i problematikave me karakter social/ekonomike dhe institucionalizimin e kujtesës historike për integrimin dhe lartësimin e vlerave morale të shtresës së ish të përndjekurve politikë.

Misioni i Sektorit të Ligjshmërisë dhe Statusit:

Bashkepunimi institucional dhe nderinstitucional per hartimin e programeve per realizimin e te gjithe te drejtave te ish te perndjekurve politike ne zbatim te legjislacionit ne fuqi.

Misioni Sektorit të Financës dhe Shërbimeve:

Programimi dhe udheheqja financiare dhe strukturore e projekteve, aktiviteteve per integrimin e ish te perndjekurve politike ne Shqiperi.

Misioni i Sektorit të Gjetjes së të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit:

Ndjekja, monitorimi dhe verifikimi i procesit per kerkimin dhe zhvarrosjen e viktimave te diktatures komuniste ne Shqiperi.

Baza Ligjore

1. Ligji Nr.7514 datë 30.09.1991 *"Për pafajësinë, Amnistinë dhe Rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë",* i ndryshuar me:

   Ligjin Nr.7662, datë 14.01.1993
   Ligjin Nr.7719 datë 08.06.1993
   Ligjin Nr.7772 datë 07.12.1993

2. Ligji Nr.7748 datë 29.07.1993 *"Për Statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga sistemi komunist"* i ndryshuar me:

   Ligjin Nr.8217 datë 13.05.1997
   Ligjin 7771 datë 07.12.2003

3. Udhëzim Nr.12 datë 16.09.1993 *"Për procedurën e dhënies së të drejtës së statusit ish të dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist"*.

4. Vendimi Këshilit të Ministrave Nr. 504 datë 18.10.1993 *"Për emëtimin e obligacioneve shtetërore për kompensimin e ish pronarëve dhe të përndjekurve Politikë"*, ndryshuar me Vkm-në Nr.9 datë 17.01.1994.

5. Ligji Nr.7598 datë 01.09.1992 dhe Vendimi Nr.392 datë 12.08.1999 *"Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish të dënuarit e të përndjekurit politikë"*.

6. Vendim Nr. 392, datë 12.8.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar", të krijuar sipas Ligjit Nr. 7598, datë 1.9.1992 "Për Ish të dënuarit dhe ish të Përndjekurit Politikë"

7. Vendimi Nr.476 datë 10.10.1994 *"Për procedurat e strehimit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist"*.

8. Vendimi Nr.184 datë 04.05.1994 *"Për dhënien e kompensimit Pasuror ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist*", ndryshuar me Vkm-në Nr.264 datë 06.06.1994.

9. Ligji Nr.9831 datë 12.11.2007 *"Për dëmshpërblimin e ish të Dënuarve Politikë të regjimit komunist",* ndryshuar me:
   Ligjin Nr.101111 datë 02.04.2009
   Ligjin 27/2017
   Ligjin 57/2018

10. *Udhëzim Nr.41, datë 09.10.2009 "Për përdorimin e Fondit Për Dëmshpërblimin e ish të dënuarve Politik të Regjimit Komunist"*.

11. Vendim Nr.419, datë 14.04.2011 *"Për miratimin e afateve dhe të Skemës së Shpërndarjes së Fondeve të Dëmshpërblimit Për Ish-Të Dënuarit Politikë të Regjimit Komunist"*.

12. Ligji Nr.7703 datë 11.05.1993 *"Për Kushtet e Përfitimit, Shumën dhe Procedurën e Dhënies së Pensioneve të Posaçme Shtetërore dhe Shtesave të Pensioneve"*.

13. Vendimi Nr.955 datë 29.12.2014 *"Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejpërdrejta të shërbimeve shëndetësore"*.

OBJEKTIVAT 2025

Bashkëpunimi me institucionet e linjës për problematikat sociale.	Të mbajë lidhje me institucione të ndryshme shtetërore për probleme të punësimit dhe shkollimit për shtresën e ish të përndjekurve politikë dhe ti ndihmojë ata për integrimin e plotë në shoqëri.
Koordinimi dhe bashkëpunimi me grupet e interest në kalendarin dhe planifikimin e aktiviteteve për kujtesën kolektive.	Hartimi dhe monitorimit te aktiviteteve te ndryshme ne perkujtim te ngjarjeve te krimeve te komunizmit si dhe per lartesimin e vlerave morale shoqerore dhe politike te kesaj shtrese nga IIPP-ja dhe shoqatat e ish te perndjekurve politike.
Minimizimi i problematikave ekonomike	Kontakt me të gjitha institucionet jo buxhetore për gjetjen e burimeve për fondin e 1%. Takime dhe kontakt për tju gjendur më pranë familjarëve të ish të përndjekurve politikë. Klasifikimi dhe trajtimi i kerkesave emergjente per ndihma ekonomike per ish te perndjekurve.

Plotësimi i databases për të zhdukurit nga krimet e komunizmit.	Mbledhja e deshmive reale nga te mbijetuarit e diktatures, ndjekja dhe monitorimi i procesit te kerkimit per gjetjen e te zhdukurve ne te gjithe fazat e tij.
Koordinimi dhe bashkepunimi me te gjithe organet ligjzbatuese qendrore, institucione , organizma dhe donatore te huai.	Bashkëpunimi, shkëmbim informacioni dhe koordinim ndër institucional për çdo faze të zhvillueshmërisë së gjetjes së eshtrave nga krimet e komunizmit.
Përgatitja dhe menaxhimi i buxhetit të IIPP-së	Administrimi me efektivitet i burimeve financiare buxhetore dhe jobuxhetore te IIPP-se, ne perputhje me zhvillimet ligjore, buxhetore dhe financiare.
Planifikimi dhe menaxhimi i stafit të IIPP-së	Menaxhimi i burimeve njerzore te IIPP-se, trajnimet si dhe administrimi i dokumentacionit te stafit ne IIPP ne perputhje me legjislacionin.

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE

Kjo analizë vjetore financiare është hartuar në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për menaxhimin e financave publike, në veçanti të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve nënligjore përkatëse për raportimin financiar dhe monitorimin e buxhetit. Dokumenti përgatitet në kuadër të ushtrimit të transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit të brendshëm financiar publik.

Analiza pasqyron përdorimin e fondeve buxhetore të akorduara për Institutin Integrimit ish te Perndjekurve Politike, institucion shtetëror përgjegjës për trajtimin, integrimin dhe mbështetjen e ish-të përndjekurve politikë, në përputhje me Ligjin Nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve", I ndryshuar, Ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë të regjimit komunist", si dhe politikat dhe programet buxhetore të miratuara për vitin raportues.

Ky raport vjetor ka për qëllim analizimin e realizimit të buxhetit të miratuar për Institutin e Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe buxhetor të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Analiza fokusohet në vlerësimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit, identifikimin e devijimeve nga planifikimi fillestar, si dhe në vlerësimin e eficiencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.

Raporti shërben si bazë për forcimin e procesit të planifikimit buxhetor afatshkurtër dhe afatmesëm, në përputhje me Kuadrin Afatmesëm të Shpenzimeve (KASH), si dhe për përmirësimin e performancës financiare dhe institucionale të institutit.

Veprimtaria financiare e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht:

- Ligji nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të ish-të Përndjekurve", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin";
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit";
- Urdhri nr. 667, datë 06.11.2023 "Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë";
- si dhe të gjitha udhëzimet dhe urdhrat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të buxhetit të shtetit.

Zbatimi i këtij kuadri ka garantuar ligjshmëri, transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e fondeve publike.

Planifikimi buxhetor është realizuar në përputhje me objektivat strategjike të institucionit dhe kufijtë buxhetorë të miratuar në KASH. Fondet e akorduara janë planifikuar sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve, duke reflektuar nevojat reale për funksionimin dhe përmbushjen e misionit institucional.

Zbatimi i buxhetit është kryer në respektim të disiplinës buxhetore, procedurave standarde të shpenzimeve dhe afateve të raportimit, duke siguruar përdorimin e fondeve vetëm për qëllimet e miratuara.

Gjatë vitit raportues 2025, niveli i realizimit të buxhetit ka qenë në përputhje me planifikimin fillestar, me devijime të kufizuara që lidhen kryesisht me faktorë objektivë, si dinamika e nevojave operacionale dhe ritmi i zbatimit të aktiviteteve institucionale.
Devijimet eventuale janë menaxhuar përmes rishpërndarjeve (pakesimeve) brenda kufijve ligjorë, duke mos ndikuar negativisht në realizimin e objektivave kryesore të institucionit dhe në vazhdimësinë e shërbimeve.
Menaxhimi financiar gjatë periudhës raportuese 2025 është orientuar drejt përdorimit ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike, në përputhje me parimet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Eficienca është reflektuar në optimizimin e shpenzimeve administrative, forcimin e kontrollit të brendshëm financiar dhe përmirësimin e proceseve të planifikimit dhe monitorimit buxhetor. Efikasiteti është evidentuar në arritjen e objektivave programore dhe rezultateve të parashikuara, brenda kufijve të fondeve të miratuara, duke siguruar një raport të drejtë ndërmjet kostove dhe rezultateve të arritura.
Sektori i finances dhe Sherbimeve gjate muajit Janar 2025 ka ndjekur te gjitha procedurat per mbylljen e te gjitha veprimeve dhe rakordimeve me institucionet perkatese per mbylljen e vitit buxhetor 2024 si dhe ka mbyllur brenda afateve ligjore te gjitha pasqyrat financiare per vitin 2024. Gjithashtu kemi rakorduar me degen e thesarit per te gjitha te ardhurat dhe shpenzimet perkatese per vitin 2024.
Ky sektor eshte njohur edhe me fondet buxhetore per vitin 2025 me ane te shkresave si me poshte:
Jemi njohur me buxhetin fillestar me ane te shkreses nr 337 dt 21.01.2025 te Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, protokolluar me tonen me nr 88 dt 22.01.2025 “Dergohet plani i buxhetit per vitin 2025”, shkresen nr 273 dt 17.01.2025 te MSHMS –se prot. me tonen me nr 102 dt 24.01.2025 “ Dergohet akordim I fondit te vecante per vitin 2024 per IIPP-ne”, shkresen nr 1508/3 prot date 26.11.2025 te MSHMS-se protokolluar me tonen me nr 1270 prot date 02.12.2025 “Transferim fondi per vitin 2025”, shkresa 5063 prot date 30.12.2025 te MSHMS protokolluar me tonen me nr. 24 prot, date 09.01.2026 “Dergohet alokim fondi per zbatimin e Aktit Normativ nr 11, date 19.12.2025, per shpenzime korente.
Ky sektor gjithashtu ka zbatuar te gjitha VKM per rritjen e pagave te punonjesve mbeshtetes dhe ne sherbimin civil, konkretisht VKM-ve 421 date 26.06.2024, VKM 422 date 26.06.2024” Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar””, VKM 422 date 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar”, VKM 424 date 26.06.2024.
Gjate kesaj periudhe sektori i finances ka qene shume i angazhuar në zbatimin me korrektesi te te gjitha ndryshimeve qe jane bere per pagat sigurimet shoqerore dhe tatimet.

Ne shkurt te vitit 2025 jane bere ndryshime ne Strukturen dhe Organiken e Institutit te Integrimit ish te Perndjekurve Politike konkretisht ne sbatim te Urdherit nr.24 date 13.02.2025 te Kryeministrit per "Nje ndryshim ne Urdherin nr 244 date 06.10.2014, te kryeministrit, "Per Miratimin e Struktures dhe te Organikes se Institutit te Integrimit t eish te perndjekurve Politike" , te ndryshuar.
Ne zbatim te ketij Urdheri jane ndjekur te gjitha hapat me DAP per permbushjen dhe zbatimin e ketij urdheri me korrektesi. Gjatë vitit raportues, në kuadër të forcimit të kapaciteteve njerëzore të institucionit, nga struktura e Burimeve Njerëzore janë rekrutuar dy specialistë, përmes procedurave të zhvilluara nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil dhe konkretisht:
-Sektorin e Çeshtjeve Sociale dhe Kordinimit te projekteve (pozicion ky i ardhur si pasoje e daljes ne pension pleqerie ten je specialist znj. Mimoza Alliu shkresa nr 1085 date 15.11.2024)
-Sektorin e Gjetjes se te Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit (pozicion ky i ardhur si pasoje e doreheqjes te specialistes znj. Polikseni Koto, shkresa nr 704 date 01.08.2024)
Keto dy pozicione jane plotesuar si me poshte:
- Specialist ne Sektorin e Çeshtjeve Sociale dhe Kordinimit te Projekteve me shkresen nr Nr. Prot.1930, datë 19.03.2025, lënda: Emërimin si nëpunës civile në periudhë prove, në pozicionin Specialist, në Sektorin e Çeshtjeve Sociale dhe Kordinimit te Projekteve në Institutin Integrimit Përndjekurve Politikë, Tiranë, kategotia IV-a (IV-2)
- Specialist ne Gjetjes se te Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit me ane te shkresës Nr. Prot.1929, datë 19.03.2025, lënda: Emërimin si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist, në Sektorin e Gjetjes se te Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit, në Institutin e Integrimit ish të Përndjekurve Politikë, Tiranë, kategotia IV-b (IV-3) pozicion ky qe me ndryshimet e struktures ka kaluar automatikisht ne kategotia IV-a (IV-2).

Analiza e Shpenzimeve sipas Kategorive Ekonomike

Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike gjatë vitit raportues pasqyron një strukturë shpenzimesh të orientuar drejt mbulimit të nevojave thelbësore për funksionimin normal të institucionit dhe realizimin e objektivave programore, në përputhje me buxhetin e miratuar dhe kufijtë e përcaktuar në Kuadrin Afatmesëm të Shpenzimeve.
Shpenzime për Personelin
Shpenzimet për personelin, që përfshijnë pagat dhe kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, përbëjnë një zë kryesor të shpenzimeve korrente. Këto shpenzime janë realizuar në përputhje me strukturën organike dhe aktet normative në fuqi, duke garantuar stabilitetin e burimeve njerëzore dhe vijimësinë e funksioneve administrative dhe programore të institucionit. Menaxhimi i këtij zëri ka reflektuar eficiencë në përdorimin e fondeve, duke siguruar mbulimin e plotë të nevojave për personel pa krijuar tejkalime nga fondet e miratuara.
Shpenzime Operative dhe Mirëmbajtje
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë orientuar drejt mbështetjes së aktivitetit të përditshëm institucional, duke përfshirë shërbime, furnizime dhe shpenzime të tjera funksionale

të domosdoshme për realizimin e veprimtarisë administrative dhe shërbimeve ndaj përfituesve. Ky zë shpenzimesh është administruar me kujdes, duke synuar optimizimin e kostove dhe përdorimin racional të burimeve financiare, çka ka kontribuar në rritjen e eficiencës operative dhe në mbarëvajtjen e institucionit gjatë vitit raportues.

Shpenzime për Programet e Integrimit dhe Rehabilitimit

Shpenzimet për programet e integrimit dhe rehabilitimit të ish-të përndjekurve politikë janë realizuar në përputhje me programet buxhetore të miratuara dhe kanë qenë të orientuara drejtpërdrejt ndaj përfituesve. Ky zë shpenzimesh ka reflektuar efikasitet në arritjen e objektivave sociale të institucionit, duke siguruar shpërndarje të fondeve në përputhje me kriteret ligjore dhe nevojat reale të target-grupeve përfituese.

Shpenzime Kapitale (Investime)

Gjatë vitit raportues nuk janë parashikuar dhe nuk janë realizuar shpenzime kapitale (investime). Mungesa e fondeve për këtë kategori ka kufizuar mundësitë për investime në, pajisje dhe modernizim të kapaciteteve institucionale. Megjithatë, përmes menaxhimit eficient të shpenzimeve korrente dhe prioritizimit të nevojave thelbësore, institucioni ka garantuar vijimësinë e funksioneve bazë dhe realizimin e objektivave kryesore programore.

Vlerësim Përmbledhës

Në tërësi, struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike gjatë vitit raportues reflekton një përdorim të qëndrueshëm, eficient dhe të orientuar drejt rezultateve të fondeve publike. Shpenzimet janë realizuar brenda kufijve të miratuar buxhetorë, duke kontribuar në mbarëvajtjen institucionale dhe në përmbushjen e misionit të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Konkretisht:

Ne artikullin 600 shpenzime per paga punonjesish jemi mbeshtetur ne Urdherit nr.24 date 13.02.2025 te Kryeministrit per “Nje ndryshim ne Urdherin nr 244 date 06.10.2014, te kryeministrit, “Per Miratimin e Struktures dhe te Organikes se Institutit te Integrimit t eish te perndjekurve Politike” , te ndryshuar, VKM-ve 421 date 26.06.2024, VKM 422 date 26.06.2024” Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar””, VKM 422 date 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar”

Numri I punonjesve pergjate ketij viti ka qene Plan 23, ndersa fakti ka ndryshuar ne periudha te ndryshme te vitit nga 21 punonjes ne 23 punonjes. Fondi i realizuar ne kete ze te buxhetit ka qene 27.356.452 (Njezet e shtate million e treqind e pesedhjete e gjashte mije e katerqind e pesedhjete e dy leke).

Ne artikullin 601 "Shpenzime per sigurime shoqerore" jemi mbeshtetur ne VKM nr, 457, datë 09.07.2014 "Për disa ndryshime në vendimin nr, 1114, datë 30.07.2008 të Këshillit të Ministrave " Për disa çështje në zbatimi të ligjeve nr, 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar si dhe Ligjit nr 29/2023 "Per Tatimin mbi te Ardhurat"
Fondi I realizuar per kete ze ne buxhet ka qene 4.422.548 (katermilion e katerqind e njezet e dy mije e peseqind e dyzet e tete leke).

Ne artikullin 602 "Shpenzimet për mallra dhe shërbime" përfshijnë të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit. Këtu jane perfshire shpenzimet operative per te tretet, sic jane (drita uje, telefon, internet, karburant , makine me qera, shpenzime per qirane e objektit, shpenzime udhetimi, sherbim postar, shpenzime per mirembajtjen e faqes web, tatimet ne burim, etj) që kryhen për rritjen e efektivitetit ne pune. Buxheti i shpenzimeve operative është mjaft i rëndësishëm për të realizuar veprimtarinë e përditshme të institucionit tonë, për të përballuar punën e përditshme në përputhje me kërkesat në rritje të standarteve që kërkon shtresa e ish te perndjekurve politike. Nje pjese e madhe e ketij buxheti ka shkuar per ambjente me qera ku gjate vitit 2025 eshte lidhur kontrate e re me nr 520/2 ddate 19.06.2025 e cila I shtrin efektet financiare nga data 01.07.2025, pasi godina ku zhvillonim aktivitetin e punes eshte demtuar nga termeti I dates 26 Nentor 2019, prandaj nje pjese e fondeve tek art. 602 shkojne per kete shpenzim, dua te theksoj se pavarsisht qe godina qe eshte ne perdorim nga IIPP me VKM nr 189 date 09.03.2011 "Per ndryshimin e e pergjegjesise se administrimit te mjediseve te katit te pare te viles 2-kateshe ne rr. Xhorxh W.Bush nga Instituti Integrimit ish te Perndjekurve Politike ne tek Insituti I Studimeve te Krimeve te Komunizmit ne Shqiperi" dhe eshte perfunduar rikonstruksioni I saj, ne akoma nuk jemi kthyer ne godinen tone pasi Ministria e Kultures do qe kjo godine te kaloje si muze Arti, (meqenese eshte monument kulture dhe eshte ne pronesi te kesaj ministrie).
Institucioni yne eshte njoftuar nga ministria pergjegjese Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale qe te vazhdoje procedurat ligjore per nenshkrimin e kontrates per ambjente me qera ne baze te shkreses nr 1315/3 date 13.06.2025 te MSHMS protokoluar me tonen me nr 248/2 date 20.06.2025
Fondi I realizuar per kete ze ne buxhet per vitin 2025 eshte 6.481.121 (Gjashte million e katerqind e tetedhjete e nje mije e njeqind e njezet e nje leke).

Ne artikullin 604 Shpenzime per transferta per ish te perndjekurit politike, Instituti mbeshtetet ne Ligjit nr.7598 datë 01.09.1992 "Per Krijimin e Fondit te Vecante Monetar per ish te Denuarit e te Perndjekurit Politike" VKM nr 392 dt 12.08.1999 "Për Administrimin e Fondit të Veçantë për të Dënuarit dhe të Përndjekurit Politikë".

Nga buxheti i shtetit miratohet cdo vit nje ze i vecante ne buxhetin e shtetit per ish te perndjekurit politike ne vlere 3.000.000 leke. Gjithashtu institucioni yne ka trasheguar nga viti 2024te ardhura te arketuara ne mbeshtetje te Ligjit nr.7598 datë 01.09.1992 "Per Krijimin e Fondit te Vecante Monetar per ish te Denuarit e te Perndjekurit Politike"me vlere 39.054.313 leke si dhe per viti 2025 jane arketuar nga zbatimi i Ligjit te mesiperm te ardhura me vlere 45.403.794 (Dyzet e pese million e katerqind e tre mije e shtateqind e nentedhjete e kater leke) te cilat pjeserisht jane shperndare sipas VKM 50% per shoqatat e ish te perndjekurve politike dhe 50% per ndihma ekonomike.
Ne total per vitin 2025 ky ze eshte realizuar ne masen 98.6% pjesa e buxhetit te shtetit dhe ne masen 13.6% pjesa e te ardhurave qe arketohet nga Ligji i 1%.
Ne total fondi I realizuar per kete ze Art. 604/1 dhe 604/4 eshte 14.479.000 leke.
Per detaje me te vecanta ne lidhje me kete ze te buxhetit eshte sektori I ceshtjeve sociale dhe Kordinimit te Projekteve qe ka ndjekur hap pas hapi realizimin e tij.

Ne artikullin 606 Kompensime Sociale dhe te tjera e cila gjen zbatim mbi baze te Vendimin Nr.929, Datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për Krijimin dhe Përdorimin e Fondit të veçantë" i ndryshuar per vitin 2025 eshte perdorur per shperblim te nje punonjese per dhenie ndihme te menjehershme per punonjesit mbeshtetes sipas VKM nr. 846, datë 26.12.2024 "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme per rast fatkeqesie (vdekje te nje pjestari te familjes)" si dhe per pagesen e telefonit te titullarit , konkretisht ky ze I buxhetit eshte realizuar ne vleren 54.380 ku (30.000 leke eshte ndihme e menjehershme sipas VKM nr 929 date 17.11.2010 dhe pjesa tjeter sipas VKM nr 673 date 02.09.2020)

Gjithashtu, në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve si dhe tabelen e e realizimit te shpenzimeve ne raport me planin :

Artikulli	Emertimi	Realizimi vjetor	Struktura ne %
600	Shpenzime per Paga	27.356.452	51.8%
601	Sigurime shoqerore	4.422.548	8.4%
602	Mallra dhe Sherbime	6.481.121	12.3%
604	Transferta individesh	2.960.000	5.6%
604/6	Transferta individesh	11.519.000	21.8%
606	Kompensime Sociale	54.380	0.1%
	Totali	**52.793.501**	**100%**

Analiza e Shpenzimeve sipas Kategorive Ekonomike (Plan–Fakt)
Gjatë vitit raportues, buxheti i miratuar për institucionin në vlerën totale prej **128,909,107 lekë** është realizuar në masën **52,793,501 lekë**, ose rreth **41%** e fondit të planifikuar. Struktura e

realizimit reflekton orientimin e shpenzimeve drejt mbulimit të nevojave prioritare dhe funksioneve bazë të institucionit, në përputhje me fondet efektivisht të disponueshme.

Shpenzime për Personelin (Paga dhe Sigurime Shoqërore)

Shpenzimet për paga janë planifikuar në vlerën **29,500,000 lekë** dhe janë realizuar në masën **27,356,452 lekë**, ose rreth **93%** e planit vjetor. Ndërkohë, shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në masën **4,422,548 lekë** nga **5,332,000 lekë** të planifikuara, duke reflektuar një nivel realizimi të kënaqshëm dhe në përputhje me dinamikën e pagave të realizuara.

Ky nivel realizimi tregon një menaxhim eficient të burimeve njerëzore dhe respektim të disiplinës buxhetore, duke garantuar stabilitetin e personelit dhe vijimësinë e funksioneve administrative dhe programore të institucionit.

Mallra dhe Shërbime

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë planifikuar në vlerën **6,519,000 lekë** dhe janë realizuar në masën **6,481,121 lekë**, ose mbi **99%** e fondit të planifikuar. Ky nivel shumë i lartë realizimi dëshmon për një planifikim realist të nevojave operative dhe për përdorim efikas të fondeve, duke siguruar funksionimin normal të institucionit dhe mbështetjen e aktivitetit të përditshëm administrativ.

Transferta për Individë dhe Kompensime Sociale

Shpenzimet për transferta për individë dhe kompensime sociale paraqesin devijime të ndjeshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit. Konkretisht:

- nga **3,000,000 lekë** të planifikuara për transferta për individë, janë realizuar **2,960,000 lekë**, ose rreth **99%** e planit;
- ndërkohë, nga një fond i planifikuar prej **84,458,107 lekë** për transferta për individë në kuadër të programeve të veçanta, janë realizuar vetëm **11,519,000 lekë**;
- shpenzimet për kompensime sociale janë realizuar në vlerën **54,380 lekë** nga **100,000 lekë** të planifikuara.

Niveli i ulët i realizimit në këtë kategori lidhet kryesisht me faktorë objektivë, si kufizimet në fondet efektivisht të disbursuara dhe dinamika e zbatimit të programeve sociale, dhe jo me mungesë eficience në administrimin financiar. Megjithatë, shpenzimet e realizuara janë orientuar drejt përfituesve prioritarë, duke ruajtur efikasitetin social të fondeve të përdorura.

Vlerësim Përmbledhës i Strukturës së Shpenzimeve

Në tërësi, analiza sipas kategorive ekonomike tregon se fondet e realizuara janë përqendruar kryesisht në shpenzime korrente thelbësore, si paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative, duke garantuar mbarëvajtjen institucionale dhe realizimin e funksioneve bazë. Pavarësisht nivelit të ulët të realizimit total krahasuar me planin vjetor, përdorimi i fondeve të disponueshme është karakterizuar nga eficiencë dhe prioritarizim i nevojave reale, në përputhje me parimet e menaxhimit financiar publik.

Konkretisht tabela e permbledhur:

Artikulli	Emertimi	Plan	Fakt	Realizimi ne %
600	Shpenzime per Paga	29.500.000	27.356.452	**92.7 %**
601	Sigurime shoqerore	5.332.000	4.422.548	**83.0 %**
602	Mallra dhe Sherbime	6.519.000	6.481.121	**99.4 %**
604	Transferta individesh	3.000.000	2.960.000	**98.7 %**
604/6	Transferta individesh	84.458.107	11.519.000	**13.6 %**
606	Kompensime Sociale	100.000	54.380	**54.4 %**
	Totali	**128.909.107**	**52.793.501**	**41.0 %**

Duke qene se Sektori i finances dhe sherbimeve mbulon edhe burimet njerezore te institucionit ne si sektor kemi ndjekur te gjitha korespondenat nepermjet e-mail zyrtare me burimet njerezore te MSHMS si dhe me DAP.

Gjate vitit 2025

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore gjatë vitit raportues 2025 është orientuar drejt garantimit të një strukture organizative funksionale, forcimit të kapaciteteve profesionale dhe sigurimit të vijimësisë së shërbimeve institucionale, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe objektivat strategjike të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Në kuadër të planifikimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të strukturës organike, gjatë vitit raportues janë evidentuar dy vende të lira pune, të krijuara si pasojë e daljes në pension pleqërie të një specialisti dhe dorëheqjes vullnetare të një specialisti tjetër. Këto ndryshime janë dokumentuar përkatësisht me shkresën nr. 1085, datë 15.11.2024 dhe shkresën nr. 704, datë 01.08.2024, dhe kanë kërkuar ndërhyrje të menjëhershme për plotësimin e strukturës, me qëllim ruajtjen e kapaciteteve funksionale të institucionit.

Procesi i rekrutimit për këto dy pozicione është realizuar përmes procedurave të zhvilluara nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), në përputhje të plotë me legjislacionin për shërbimin civil, duke respektuar parimet e transparencës, meritokracisë dhe konkurrencës së ndershme. Si rezultat i këtyre procedurave, janë emëruar dy nëpunës civilë në periudhë prove, si më poshtë:

- një Specialist në Sektorin e Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve, i emëruar me shkresën nr. prot. 1930, datë 19.03.2025, në kategorinë IV-a (IV-2), pozicion ky i rëndësishëm për zbatimin e politikave sociale dhe koordinimin e projekteve institucionale;
- një Specialist në Sektorin e Gjetjes së të Zhdukurve nga Krimet e Komunizmit, i emëruar me shkresën nr. prot. 1929, datë 19.03.2025, fillimisht në kategorinë IV-b (IV-3), pozicion

i cili, pas ndryshimeve të miratuara në strukturën organizative të institucionit, ka kaluar automatikisht në kategorinë IV-a (IV-2).

Plotësimi i këtyre pozicioneve ka kontribuar në rritjen e stabilitetit të strukturës së burimeve njerëzore dhe në përmirësimin e ndarjes funksionale të përgjegjësive, duke ndikuar pozitivisht në eficiencën e punës dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Menaxhimi i burimeve njerëzore gjatë vitit raportues ka qenë i orientuar drejt përdorimit optimal të kapaciteteve ekzistuese, ruajtjes së vazhdimësisë institucionale dhe mbështetjes së realizimit të misionit të institucionit, në përputhje me kërkesat e raportimit dhe standardet e përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu gjate ketij viti asistentja e Drejtorit te Pergjithshem eshte shpallur fituese ne DAP dhe vendi i saj eshte plotesuar me nje punonjese te re.

Specialistja protokoll arkives ka marre leje lindje dhe ky pozicion eshte plotesuar me nje punonjese te re.

Me poshte po paraqesim strukturen aktuale te IIPP-se

STRUKTURA E INSTITUTIT TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

KATEGORIA		**NUMRI**	.
I.	**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**	**I-4**	**1**
	SEKRETAR I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM		1
	ZV/ DREJTOR I PERGJITHSHEM	**II-1**	1
II.	**SEKTORI I LIGJSHMËRISË DHE STATUSIT**		**(5)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	**III-2**	1
	SPECIALIST	**IV-a**	2
	SPECIALIST	**IV-2**	2
III.	**SEKTORI I ÇËSHTJEVE SOCIALE,KORDINIMIT ME SHOQATAT DHE PROJEKTEVE**		**(6)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	**III-2**	1
	SPECIALIST	**IV-2**	1
	SPECIALIST	**IV-2**	4
IV.	**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS**		**(6)**
	PËRGJEGJËS SEKTORI	**III-2**	1
	SPECIALIST FINANCË	**IV-2**	1
	ARSHIVIST-PROTOKOLIST		1
	SHOFER KORRIER		1
	PUNONJËS INFORMACIONI		1
	SANITARE		1
V.	**SEKTORI I GJETJES SË TË ZHDUKURVE NGA KRIMET E KOMUNIZMIT(3)**		
	PËRGJEGJËS SEKTORI	**III-2**	1
	SPECIALIST	**IV-2**	1
	SPECIALIST	**IV-2**	1

TOTALI I PUNONJËSVE **(23)**

Në përfundim, menaxhimi i buxhetit gjatë vitit 2025 ka qenë i qëndrueshëm dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Përmirësimi i mëtejshëm i planifikimit buxhetor, forcimi i analizës së performancës financiare dhe rritja e lidhjes ndërmjet burimeve financiare dhe rezultateve të arritura mbeten prioritete për periudhat në vijim.

SEKTORI I LIGJSHMËRISË DHE STATUSIT

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, janë lëshuar 395 **Vërtetime për Dhënie Statusi** për personat ish të përndjekur politikë sipas kërkesave të tyre. Këto vërtetime janë dhënë në bazë të Vendimeve të Komisionit Shtetëror tre Palësh, sipas Nenit 3 të Ligjit Nr. 7748 datë 29.07.1993 "Për Statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar me Ligjet Nr.8217 datë 13.05.1997 dhe Nr.8665 datë 18.09.2000.

- **Në fushën e arsimit**

Për studentë me prindër ish të dënuar dhe të përndjekur politikë, për të paguar tarifën e shkollimit sipas legjislacionit në fuqi, në ndihmë të kësaj shtrese.

- **Për pensione**

Shumë persona ish të përndjekur politikë, që kanë mbushur moshën e pensionit, këto vërtetime I depozitojnë pranë Sigurimeve Shoqërore. Sipas viteve të përndjekjes, kjo kohë llogaritet ose shtesë pensioni, ose vite vjetërsie pune.

- **Për punësim**

Shumë ish të përndjekur politikë, janë paraqitur pranë zyrës së Statusit, për të tërhequr këtë vërtetim, për të patur lehtësira për punë.

- **Për jashtë vendit**

- **Për strehim**

Personat me Status Politik, mund të përfitojnë shtëpi me kredi të butë. Kjo është një nga kërkesat e formularit , pranë bashkisë së Tiranës, që duhet të plotësojnë personat për të përfituar shtëpi me kredi të butë.

- **Për ndihma ekonomike**

Personat ish të dënuar që trajtohen me ndihmë ekonomike pranë IIPP-së, pajisen me Vërtetime për Dhënie Statusi.

- **Për sponsorizime librash dhe aktivitetet e shoqatave**

Për shërbimet e ofruara nga IIPP, Vërtetimi për Dhënie Statusi është dokument parësor.

- **Për probleme të ndryshme.**

Këto Vërtetime janë lëshuar sipas statistikës së mëposhtme:

STATISTIKA PËR PERSONAT ME STATUS POLITIK

Nr	GRUPI	PERFITUES STATUSI
1	A	5548 (të pushkatuar)
2	A1	273 (të sëmurë mendorë)
3	B	14563 (të burgosur)
4	B1	987 (të vdekur në burg)
5	C	21401 (të internuar e të dëbuar)
	TOTALI	**42772**

2.Janë nxjerrë të dhënat e statusit për 180 dosjet e ish të dënuarve politikë sipas kërkesave të personave/trashëgimtarëve të ish të dënuarve politikë nga sistemi komunist, që këta persona t`i drejtohen Arkivit të IIPP-së, Ministrisë së Drejtësisë, gjykatave etj. për t`u pajisur me dokumentat e tjerë (fotokopje) që gjenden pranë nesh.

3.Kanë kontribuar me konsulencë ligjore përkrah sektorëve të tjerë për problemet që dalin gjatë ushtrimit të punës së përditshme për sa i përket bazës ligjore ku duhet të mbështeten në: problematikat e pensioneve, problematikat e burimeve njerëzore, në procedurën e bashkëpunimit me organizma ndërkombëtar dhe institucione të cilat bashkërendim punën për gjetjen e eshtrave të të zhdukurve nga krimet e komunizmit.

4.Në mbështetje të ligjit nr. 9831, dt.12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist", është ndjekur zbatimi i të gjithë kërkesave të ardhura nga ish të dënuarit dhe trashëgimtarët e tyre, duke bërë për çdo rast sqarimet e duhura dhe duke përcjellë ankesat dhe kërkesat pranë institucioneve përkatëse.

5.Ka kontaktuar dhe i ka dhënë zgjidhje shumë problematikave të personave ish të përndjekur politik të paraqitur në Sektorin e Ligjshmërisë dhe Statusit, ku të shumtë kanë qënë mbi mosvlerësimin e saktë të masës së dëmshpërblimit, kështillim ligjor mbi dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm ligjor pranë Ministrisë së Financave për përfitimin e kështit të tretë dhe katërt, nevojshmëri për interpretim dhe saktësim të përgjgigjeve të marra dhe konsulencë drejt zgjidhjeve të problemeve.

6.Ka dhënë konsulencë ligjore lidhur me bazueshmërinë në ligj të projekteve të hartuara nga ana e institucionit në kuadrin e programeve rehabilituese dhe integruese në dobi të të përndjekurve politikë.

7.Ka pritur dhe sqaruar qytetarë në lidhje me listat e publikuara nga Ministria e Financave, për dokumentacionin që duhet të depozitojnë trashëgimtarët e ish të dënuarve politikë pranë kësaj ministrie, për këstet ne vazhdimesi.

8.Konsulencë ligjore per çështje të ndryshme të konstatuara rreth personave ish të përndjekur politikë. Konkretisht:

- Njohja me dokumentat e paraqitura nga ish te perndjekurit politikë per njohjen e viteve të përndjekjes politike.
- Komunikimi ndër institucional.
- Ndjekje në rrugë gjyqësore të çështjeve ku instituti jemi palë paditëse/ të paditur/person i tretë.
- Kthim përgjigje kërkesave të drejtuara Institutit tonë për çështjet juridike.

9.Ka bashkëpunuar me sektorët e tjerë të IIPP-së duke nxjerrë statisika nga database i personave ish të dënuar me status politik.

10. Ka bashkëpunuar me Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për dërgimin e listës me persona të dënuar politikë nga sistemi komunist, verifikuar me listat e Komisionit Shtetëror Tre Palësh në mënyrë që këta ish të dënuar të futen në librat e Enciklopedisë (që botohen nga ky institucion) sipas përndjekjes që ata kanë.

11.Ka bashkëpunuar me Autoriten e Hapjes së Dosjeve, për dërgimin e Vërtetimeve për Dhënie Statusi sipas kërkesave të bëra nga persona ish të dënuar politikë apo trashëgimtarët e tyre.

12. Gjatë gjashtëmujorit të parë të punës, janë sqaruar ish të përndjekur politikë në lidhje me dosjet jashtë afatit të dorëzuara pranë Ministrisë së Drejtësisë.

13. Ka pritur dhe sqaruar 125 qytetarë në lidhje me listat e publikuara nga Ministria e Financave, për dokumentacionin që duhet të depozitojnë trashëgimtarët e ish të dënuarve politikë pranë kësaj ministrie, për këstin e tretë dhe të katërt.

14. Janë pritur dhe sqaruar qytetarë në lidhje me problematikat e hasura me miratimin e dosjeve për dëmshpërblim nga Ministria e Drejtësisë.

15.Eshtë mbajtur korrespondenca me shkresa zyrtare me Ministrinë e Drejtësisë, atë të Financave në lidhje me ecurinë e dëmshpërblimit për këstin e katërt dhe të pestë.

16. Ka asistuar në grupet e punës të cilat janë ngritur për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në institucion "Auditim përputhshmërie në Instiutin e Integrimit ish të Përndjekurve Politikë".

17.Ka përfaqësuar IIPP-në, me autorizim me shkrim të Titullarit të Institucionit në marrëdhënie me të tretët, pushtetin vendor, pushtetin qendror, kryesisht gjykatat për zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve ligjore të paraqitura.

I. Koordinimi dhe Konsulenca Ligjore

- Është realizuar koordinimi i punës si njësi e specializuar për çështjet ligjore në institucion.
- Është dhënë në mënyrë të vazhdueshme konsulencë ligjore sektorëve të tjerë për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përditshme.
- Është ofruar konsulencë lidhur me bazueshmërinë ligjore të projekteve rehabilituese dhe integruese në dobi të ish të përndjekurve politikë.
- Është bashkëpunuar për përmirësimin e kuadrit ligjor të institucionit, përfshirë ndryshime në Rregulloren për Funksionimin dhe Organizimin e Komisionit të Administrimit dhe Komisionit të Monitorimit të Fondit të Veçantë Monetar.
- Janë hartuar urdhra dhe akte të ndryshme administrative në funksion të organizimit dhe mbarëvajtjes së punës.

II. Dhënia e Vërtetimeve për Statusin Politik

Gjatë vitit 2025 janë lëshuar **1040 Vërtetime për Dhënie Statusi** për personat ish të përndjekur politikë, në bazë të vendimeve të Komisionit Shtetëror Trepalësh, sipas Nenit 3 të Ligjit Nr. 7748, datë 29.07.1993, i ndryshuar.

Këto vërtetime janë përdorur për:

- **Arsim** – për studentë me prindër ish të dënuar/përndjekur politikë, për përfitim nga tarifat e shkollimit.
- **Pensione** – për njohjen e viteve të përndjekjes si vjetërsi pune ose shtesë pensioni pranë Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- **Punësim** – për përfitim lehtësish në procedurat e punësimit.
- **Dokumentacion jashtë vendit** – si dokument mbështetës për autoritetet e huaja.
- **Strehim** – për aplikime për kredi të buta pranë Bashkia Tiranë.
- **Ndihmë ekonomike** dhe shërbime të tjera institucionale.
- **Sponsorizime librash dhe aktivitete përkujtimore të shoqatave.**

Statistika e Përgjithshme e Personave me Status Politik

Nr	Grupi	Përfitues
1	A (të pushkatuar)	5548
2	A1 (të sëmurë mendorë)	273

Nr	Grupi	Përfitues
3	B (të burgosur)	14563
4	B1 (të vdekur në burg)	987
5	C (të internuar e të dëbuar)	21401
	TOTALI	**42772**

III. Shërbimi ndaj Qytetarëve dhe Trajtimi i Kërkesave

- Janë pritur dhe sqaruar rreth **550 ish të përndjekur politikë** lidhur me dosje jashtë afatit ligjor pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Rreth **200 persona** janë sqaruar për dosje me mangësi dokumentacioni.
- Rreth **350 persona** janë interesuar për dosjet e kategorisë C të pashqyrtuara ende.
- Janë trajtuar ankesa për kategorinë A (të pushkatuar para 30 nëntorit 1944) dhe kategorinë B (trashëgimtarët ligjorë), në bazë të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007.
- Janë sqaruar rreth **250 persona** për përfitimin e statusit të ish të përndjekurit politik.
- Janë asistuar qytetarë për nxjerrjen e certifikatave nga platforma e-Albania si pjesë e dokumentacionit për ndihmë ekonomike.
- Është realizuar korrespondencë zyrtare me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Avokatin e Popullit dhe institucione të tjera.

IV. Veprimtaria Gjyqësore dhe Administrative

- Institucioni është përfaqësuar në procese gjyqësore si palë paditëse, palë e paditur ose person i tretë.
- Janë përfunduar **2 procese gjyqësore** me vendim në favor të institucionit.
- Një çështje është në Gjykatën e Apelit, ndërsa të tjerat janë në vijim.
- Janë zhvilluar **9 procedura prokurimi** sipas planit vjetor.
- Vazhdon procesi i regjistrimit në database i dosjeve për përfitimin e statusit.

V. Bashkëpunimi Institucional dhe Arkivor

- Janë nxjerrë të dhëna për **357 dosje** për persona/trashëgimtarë, për t'iu drejtuar arkivave dhe institucioneve të tjera për dokumentacion shtesë.

- Është bashkëpunuar me gjykatat dhe institucione publike për vërtetime dhe fotokopje dokumentesh arkivore.
- Është bashkëpunuar me
  Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për dërgimin e vërtetimeve sipas kërkesave.

VI. Veprimtaria në Arkiv dhe Ruajtja e Kujtesës Historike

Është punuar për hapjen dhe përpunimin e dosjeve arkivore me qëllim zbardhjen e historisë së kampeve të internimit në Valias dhe Kamëz.

Sipas të dhënave arkivore:

- Kampi i Valiasit: **44 të dënuar**
- Kampi i Kamzës: **226 të dënuar**

Gjithashtu, në bashkëpunim me shoqata përfaqësuese, është përpiluar lista emërore e **5492 personave të ekzekutuar me dhe pa gjyq**, në kuadër të iniciativës për ndërtimin e "Murit të Kujtesës".

Kjo veprimtari synon ruajtjen e kujtesës kolektive, dokumentimin e dëshmive historike dhe nderimin e viktimave të regjimit komunist.

SEKTORI I ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE KOORDINIMIT TË PROJEKTEVE

Instituti i Integrimit të Ish-Përndjekurve Politikë është një institucion që ka si mision mbështetjen dhe integrimin e ish-përndjekurve politikë që kanë vuajtur nga regjimi komunist në Shqipëri. Ky institucion merret me një gamë të gjerë aktivitetesh, përfshirë asistencën sociale, rehabilitimin dhe mbështetje në punësim për ish-përndjekurit politikë dhe familjet e tyre.

Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve brenda këtij institucioni ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe koordinimin e projekteve që lidhen me përmirësimin e kushteve të jetesës për ish-përndjekurit. Ky sektor merret me:

1. **Mbështetje sociale dhe asistencë**: Ofrimi i shërbimeve të nevojshme sociale për ish-përndjekurit dhe familjet e tyre, si dhe ndihma në integrimin e tyre në shoqëri.
2. **Koordinimi i projekteve**: Organizimi dhe mbështetje e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale për këtë kategori, si edhe organizimin e

aktiviteteve edukative dhe profesionale për t'i ndihmuar ata të integrohen më mirë në tregun e punës.

3. **Krijimi i mundësive për formimin profesional**: Sigurimi i mundësive për përmirësimin e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të ish-përndjekurve politikë për t'i ndihmuar ata në gjetjen e punës.
4. **Përfaqësimi dhe sensibilizimi**: Angazhimi në aktivitete për të promovuar të drejtat e ish-përndjekurve dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me vuajtjet dhe përvojat e tyre gjatë regjimit komunist.

Ky sektor ka si qëllim të kontribuoni në integrimin social dhe ekonomik të ish-përndjekurve politikë dhe t'i ndihmojë ata të gjejnë një jetë më të mirë dhe të barabartë në shoqëri.

Objektiva kryesore e sektorit të çështjeve sociale dhe koordinimit të projekteve ka qënë trajtimi i problematikave me karakter social/ekonomike dhe institucionalizimin e kujtesës historike për integrimin dhe lartësimin e vlerave morale të shtresës së ish të përndjekurve politikë.

Gjatë vitit 2025, Instituti i Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP) ka përqendruar veprimtarinë e tij në përmirësimin e kushteve sociale dhe mbështetjen e integrimit të plotë të ish-të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre. Në këtë kuadër, Instituti ka siguruar ndihmë sociale dhe shërbime të nevojshme për kategorinë më të vulnerabilizuar, duke përfshirë mbështetje për nevojat emergjente dhe lehtësimin e aksesit të tyre në shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale në bashkëpunim me institucionet e linjës. Këto ndërhyrje kanë synuar garantimin e një integrimi të plotë shoqëror dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për këtë kategori.

IIPP ka zhvilluar dhe koordinuar projekte të ndryshme për integrimin socio-ekonomik, duke përfshirë aktivitete për zhvillimin e aftësive profesionale dhe edukimit, që synojnë të rrisin mundësitë e punësimit dhe pjesëmarrjen aktive të ish-të përndjekurve në jetën ekonomike dhe shoqërore. Në kuadër të këtyre projekteve, Instituti ka organizuar gjithashtu aktivitete përkujtimore dhe nisma që mbështesin ruajtjen e kujtesës historike, në përputhje me kalendarin e kujtesës dhe propozimet e marrë nga përfaqësues të ish-të përndjekurve politikë.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë ka qenë mbështetja dhe asistenca për integrimin në tregun e punës. Instituti ka bashkëpunuar me punëdhënësit dhe organizata të ndryshme për të krijuar mundësi reale punësimi, duke ofruar gjithashtu programe trajnimi dhe zhvillimi të aftësive profesionale, për të përmirësuar mundësitë e përfshirjes aktive në ekonominë e vendit.

IIPP ka vazhduar gjithashtu përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të ish-të përndjekurve politikë, duke organizuar aktivitete që rrisin ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe institucioneve për problemet dhe nevojat e tyre, si dhe duke promovuar njohjen e vuajtjeve dhe historisë së kësaj kategorie.

Për të siguruar efektivitetin e veprimtarive, Instituti ka zhvilluar monitorim të vazhdueshëm të projekteve dhe aktiviteteve, duke raportuar progresin, identifikuar nevojat emergjente. Njëkohësisht, IIPP ka përqendruar përpjekjet në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore, me qëllim sigurimin e shërbimeve më të mira dhe të qëndrueshme për ish-të përndjekurit politikë.

Përmes këtyre objektivave, sektori ka për qëllim të sigurojë një integrim të qëndrueshëm dhe të plotë të ish-përndjekurve politikë në shoqërinë shqiptare, duke i mundësuar atyre një jetë të denjë dhe të barabartë

Ky sektorë brënda mundësive që disponon si financiare ashtu dhe ligjore ka realizuar objektivat e tij në formën më të mire duke krijuar kontakte për gjetjen e burimeve dhe përdorimin e tyre në mënyrë sa më efiçente për ti ardhur në ndihmë familjeve të përndjekura politikë. Ka krijuar strategji për integrimin e tyre në fushat e edukimit, trajnimit, punësimit dhe strehimit të ish të përndjekurve politikë dhe familjarëve të tyre.

Ka vijuar kontaktet për rritjen e cilësisë së shërbimit të shkëmbimi të dokumentacionet që disponohen për periudhën e diktaturës, në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, si dhe edukimit qytetar, me qëllim rishqyrtimin historik të genocidit komunist.

Menaxhimi i Pritjes me Publikun:

Aktivitetet për përputhjen dhe mbështetje në plotësimin e dokumentacionit për aplikimet e dëmshpërblimit, duke u siguruar që aplikantët (ish të përndjekur politikë, trashëgimtarë të tyre, dhe kategori të tjera të përfshira) të kenë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme.

Sektori ka menaxhuar pritjen me publikun për informim apo sqarim në lidhje me plotësimin e dokumentacioneve, si dhe ndjekje të çështjeve problematike që lidhen me kështet e dëmshpërblimit për çdo të interesuar, për trashëgimtarë ligjor, apo dhe të kategorive parësore të ish të përndjekurve politikë.

Takime me Ish të Përndjekur Politikë:

Organizimi i takimeve dhe ofrimi i informacionit për të siguruar që procesi i aplikimit dhe dëmshpërblimit të vijë në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative, përfshirë dosjet e prapambetura ose jashtë afatit. Sqarim në lidhje me plotësimin e dokumentacioneve për aplikimet dhe problematikat pranë Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të dosjeve të prapambetura ose jashtë afatit, si dhe ndjekje të çështjeve problematike që lidhen me kështet e dëmshpërblimit, kryesisht këstin e 3 dhe të 4, për çdo të interesuar, për trashëgimtarë ligjor si katëgori dytësore, apo dhe të kategorive parësore të ish të përndjekurve politikë.

Ndjekja e Çështjeve Problemike të Dëmshpërblimit:

Angazhimi për të ndjekur çështjet problematike që lidhen me kështet e dëmshpërblimit, veçanërisht me këstin e tretë dhe të katërt, duke mundësuar zgjidhje të shpejta për çdo të interesuar, si dhe për kategori parësore dhe dytësore.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

Ndërshkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit me këto institucione për çështje që kërkojnë ndërhyrje dhe sqarime të mëtejshme për proceset e pagesave dhe dëmshpërblimeve, duke krijuar ura komunikimi efikase, të cilat kërkonin një urë komunikimi për sqarime të mëtejshme midis ish të përndjekurve, dhe zyrës së Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimit. Gjatë vitit 2024, vijon lista për këstin e 4 të kategorisë jo parësore, ku në pritje fizike, apo në linjë telefonike është dhënë informacioni për dokumentacionet që duheshin të plotësoheshin, apo është konsultuar çdo problematikë. Gjithashtu, kemi qënë të pranishëm për disa çështje të ndjeshme dhe problematika të thella sipas problemeve të ish trashëgimtarëve të dosjeve të dëmshpërblimit, duke marrë informacion nga juristet e drejtorisë për rastet në fjalë.

Janë informuar nga komunikimi rreth 1520 qytetarë përgjatë vitit 2025:



Proçedurat e dëmshpërblimit përgjatë vitit 2025:

Ky aktivitet është një pjesë e rëndësishme e politikave dhe procedurave të zbatimit të dëmshpërblimeve dhe menaxhimit të çështjeve për ish të përndjekurit politikë, që kërkojnë mbështetje të vazhdueshme për të adresuar problemet dhe kërkesat e tyre në mënyrë efektive.

Ky proces është i rëndësishëm jo vetëm për administratën shtetërore, por edhe për të siguruar drejtësi dhe të drejtat e ish të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre, duke u dhënë atyre mundësinë të marrin kompensimin e merituar për vuajtjet e kaluar.

Përjashtimit nga tarifa e shkollimit e studentëve fëmijë të ish përndjekurve politikë:

Kemi kontaktuar MAS për ndryshimet ligjore, për vijimësinë që do të ndjekim në bashkëpunim me universitetet në të gjithë Republikën e Shqipërisë për ti ardhur në ndihmë fëmijëve të ish të përndjekurve politikë bazuar në Ligjin 7748, datë 29.07.1993 "Për Statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar dhe VKM- së me Nr. 269 datë 29.03.2017 (i ndryshuar). Fëmijët e ish të përndjekurve politikë, që janë të regjistruar në institucione të arsimit të lartë në vend, përfitojnë nga ky përjashtim. Ky përjashtim është i

disponueshëm për të gjithë studentët që janë të regjistruar në fakultete dhe universitetet publike. Gjithashtu janë përpiluar listat e kritereve që duhet të dorëzojnë studentët për tu pajisur me këtë vërtetim. Studentët duhet të dokumentojnë statusin e tyre si fëmijë të ish të përndjekurve politikë, me vërtetimin e dënimit, me anë të certifikatave përkatëse që vërtetojnë lidhjen familjare me prindërit e tyre. Ata mund të kenë nevojë të dorëzojnë dokumentacion shtesë, si aktet e lindjes dhe certifikatën të prindit në rast të ndryshimeve në emra ose mbiemra gjithashtu dhe vërtetimin e studentit..Janë miratuar nga DP formatet e vërtetimeve për vitin 2025 nëpërmjet të cilave studentët pajisjen dhe regjistrohen në databasen tonë për tu përfshirë në listat e dërguara tek universitetet përkatëse për ti konfirmuar universiteteve se këta student përfitojnë reduktim tarife sipas VKM-së. Kemi pritur e ndihmuar në plotësim dokumentacioni dhe pajisur me vërtetim për përjashtim nga tarifa e shkollimit për studentët fëmijë të ish të përndjekurve politikë që ndjekin studimet e larta. Në bazë të së drejtës së tyre për të përfituar nga reduktimi i tarifës së shkollimit, fëmijët e ish të përndjekurve politikë, pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës pranë zyrës sonë, pajiseshin nga kjo e fundit me vërtetimin që specifikon të drejtën e tyre dhe përfitimin pasues. Gjithashtu janë përpiluar listat dhe dokumentacioni të cilat i janë dërguar të gjithë universiteteve përkatëse. Universitetet dhe institucionet arsimore janë të detyruara të respektojnë këtë përjashtim dhe të sigurojnë që studentët e përmendur të mos paguajnë tarifën e shkollimit. Administrata shtetërore, përmes Ministrisë së Arsimit duhet të monitorojë dhe sigurojë zbatimin e këtij përjashtimi në mënyrë të rregullt dhe të sigurojë fondet e nevojshme për ta mbuluar këtë përjashtim. Ky përjashtim është një formë e njohjes për sakrificat që kanë bërë ish të përndjekurit politikë dhe familjet e tyre. Ky hap ka si qëllim jo vetëm mbështetje materiale, por edhe forcimin e solidaritetit dhe të drejtësisë sociale për ata që kanë vuajtur pasojat e regjimeve të kaluara.

Ky përjashtim është një masë e rëndësishme për të mundësuar akses të barabartë në arsimin e lartë për ata që kanë vuajtur nga regjimet e kaluar dhe për të mbështetur brezin e ri që mund të kontribuoni në zhvillimin e vendit, duke u mundësuar atyre një mundësi më të mirë për arsimim dhe karrierë pa pengesa financiare.

Referuar nenit 12 të ligjit Nr.7748 datë 29.07.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", është kryer në vijimësi korenspondenca me Institucione Shtetërore për problematikën që kanë patur pjesëtarë të kësaj shtresë, në lidhje me punësimin e tyre, me pensionet. Përkatësisht;

- Janë realizuar shkresa për qartësimin e shumave apo të drejtave të shtesës së pensionit për ish të përndjekurit politikë drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore me qëllim marrjen e një informacioni më të qartë mbi të drejtat e qytetarit specifikë dhe të detyrimeve të institucioneve shtetërore.

- Janë realizuar shkresa që adresonin problemet e strehimit drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale dhe Banesave në Përdorim të Komuniteteve të tjera si ndërmjetësim dhe përfaqësim i shtresës së ish të përndjekurve politikë prej Institutit të Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë. Gjithashtu janë kontaktuar bashki të ndryshme mbi gjetjen e ambjenteve për strehimin.

- Shkresa me listat përjashtuese nga tarifa e shkollimit të studentëve që kanë përfituar nga VKM me Nr. 269 datë 29.03.2017 (i ndryshuar), drejtuar Fakulteteve të ndryshme. Gjithashtu dhe shkresa konfirmuese të statuseve të prindërve ish të përndjekur politikë.

- Realizimi i shkresave kthim përgjigje ndaj qytetarit në lidhje me paqartësitë dhe pyetjet që kanë mbi të drejtat e tyre si trashëgimtar ish i përndjekur.

- Janë përpiluar shkresa drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi marrjen e informacionit për problematika në dosjet referuar kërkesave të ardhura.

Janë përpunuar dokumentacionet referuar rregullores së Komisionit të Administrimit të Fondit të Veçantë Monetar gjithashtu janë përpunuar dhe miratuar formatet e reja bazuar në ligjet aktuale për "Kërkesa për ndihmë ekonomike" " Deklarata e Vërtetësisë së Informacionit".
Gjithashtu kemi krijuar databazen e nevojshme për mirëmbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të personave përfitues të Fondit të Veçantë Monetar.
Një nga objektivat kryesore të këtij sektori është të sigurojë mbarëvajtjen dhe rregullsinë e dokumentacionit të depozituara nga qytetarët për ndihmë ekonomike gjithashtu dhe propozimet për projekte të shoqatave duke u bazuar në rregulloren e funksionimit të komisionit të administrimit të fondit të veçantë monetar.
Komisioni i Administrimit të Fondit të Veçantë Monetar, studion çdo kërkesë të ardhur duke e patur këtë objektiv si prioritet të saj që çon drejt realizimit të misionit të saj si një ndihmë direkte për shtresën e ish të përndjekurve politikë. Ky komision vlerëson dhe analizon kërkesat duke i klasifikuar bazuar në Ligjin Nr.7748 datë 29.07.1993 "**Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist**", Ligjin Nr.9831, Datë 12.11.2007 (ndryshuar me Ligjin Nr. 10 111, Datë 2.4.2009) "**Për Dëmshpërblimin e Ish të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist",** si dhe raportit të nevojave immediate, ku specifikohen marrjet e masave të tjera, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese apo krijimit të kushteve favorizuese, për riintegrimin shoqëror të tyre.

Sektori i Çështjeve Sociale dhe Koordimin të projekteve ka vijuar me bashkëpunimin me shoqatat dhe të përndjekurit politikë për ti ardhur në ndihmë për çdo nevojshmëri të tyre drejt integrimit dhe rehabilitimit të tyre duke i kthyer vëmendje të veçantë figurave të spikatura antikomuniste për të lënë gjurmë në kujtesën kolektive mbi vuajtjet dhe integritetit e këtyre martirëve të lirisë..



Përgjatë vitit 2025 kemi patur bashkëpunim të vazhdueshëm me shoqata të ndryshme të përndjekurve politikë të cilët kanë aktivitet në vendin tonë. Ndër aktivitetet kryesore kanë qenë :

Në vitin 2025, **822 familje** kanë përfituar nga ndihma ekonomike e shpërndarë nga **Instituti i ish të Përndjekurve Politikë (IIPP)**, duke u ofruar atyre një mbështetje të rëndësishme financiare për të përballuar nevojat e përditshme dhe vështirësitë ekonomike.

Ky proces është pjesë e një iniciative të vazhdueshme dhe prioriteti i IIPP-së për të ofruar ndihmë për kategoritë e ish të përndjekurve politikë dhe familjet e tyre, duke i ndihmuar ata të integrohen dhe të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe përballjen me nevoja emergjente, të cilat mund të jenë përkeqësuar nga historia e vuajtjeve të tyre.

Pikat kryesore të këtij procesi:

Trajtimi i kërkesave, çdo kërkesë që ka ardhur pranë IIPP-së gjatë vitit 2025 është trajtuar sipas **prioriteteve, nevojshmërisë dhe kritereve** të përcaktuara në rregulloren e fondit të veçantë monetar. Kjo ka siguruar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjitha familjet që kanë kërkuar ndihmë.

Kriteret e përzgjedhjes për ndihmën ekonomike janë të bazuara në nevojat e theksuara sociale dhe ekonomike të familjeve, statusin e familjeve të ish të përndjekurve politikë dhe kategorinë e trashëgimtarëve aplikues për ndihmë ekonomike, situatën e përgjithshme ekonomike të familjes dhe faktorët e tjerë që mund të ndikojnë në përfshirjen e tyre në këtë mbështetje rastet e sëmundjeve, humbjes së jetës emergjencës së trajtimit.

Çdo vit, ndihma ekonomike për ish të përndjekurit dhe familjet e tyre mbetet një nga prioritetet kryesore të IIPP-së. Kjo mbështetje është një formë kompensimi për vuajtjet dhe sakrificat që kanë

bërë këta individë dhe familje, duke iu siguruar mbështetje në periudha të vështira financiare. Fondi i veçantë monetar siguron burimet financiare për dhënien e ndihmës ekonomike. Ky fond është menaxhuar me transparencë dhe përgjegjshmëri për të siguruar që mbështetja të shkojë tek ata që kanë nevojë më shumë.

Rëndësia e ndihmës ekonomike:

Kjo masë mbështetëse është një hap i rëndësishëm për të mbajtur vazhdimësinë e kujdesit ndaj ish të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre, duke u mundësuar atyre që të jetojnë me dinjitet dhe të përballojnë sfidat e jetesës. Ajo ndihmon në uljen e pabarazisë dhe ofron mundësi për këto familje për të përfituar nga shërbime dhe mbështetje shtesë që do t'i ndihmojnë në realizimin e kushteve më të mira jetese.

Në përfundim, kjo formë është një pjesë thelbësore e përpjekjeve për të njohur vuajtjet e ish të përndjekurve politikë dhe për të siguruar mbështetje afatgjatë për ta, si një institucion përkrahës i vazhdueshëm i interesave të kësaj shtrese duke siguruar që ata dhe pasardhësit e tyre të kenë mundësi të barabarta për t'u zhvilluar.



Përgjatë vitit 2025, **janë organizuar 19 aktivitete në bashkëpunim me 7 Shoqata dhe Institucione të tjera të linjës referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit** si një prioritet ndër vite e **Institutit të ish Përndjekurve Politikë (IIPP)**, duke u ofruar përkrahje çdo shoqate përfaqësuese të shtresës së ish përndjekurve politikë por gjithashtu dhe shoqatave të reja që duan të hedhin dritë mbi të shkuarën për realizimin e sa më shumë aktiviteteve për kujtimin dhe integrimin e kësaj shtrese si misioni thelbësor i vet ekzistencës së këtij institucioni.

Gjatë vitit 2025, **Instituti i Ish Të Përndjekurve Politikë (IIPP)** ka realizuar **19 aktivitete** të rëndësishme në bashkëpunim me **7 shoqata dhe institucione të tjera** të linjës, duke forcuar angazhimin dhe mbështetjen për **ish të përndjekurit politikë** dhe përfaqësuesit e tyre. Ky aktivitet

ka për qëllim të sigurojë një mbështetje më të gjerë për ata që kanë vuajtur nga regjimet e kaluar dhe të ofrojë mundësi për avancimin e të drejtave dhe interesave të tyre.

Pikat Kryesore të Aktivitetëve:

Gjatë kësaj periudhe raportimi, Instituti i Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP) ka zhvilluar një seri aktivitetesh në bashkëpunim me shoqata dhe institucione të linjës, të cilat përfaqësojnë interesat e ish-të përndjekurve politikë. Ky bashkëpunim ka krijuar një rrjet mbështetjeje dhe koordinimi, duke siguruar që ndihma dhe shërbimet për përfituesit të jenë më efektive dhe të shtrira në mënyrë gjithëpërfshirëse. Veprimtaria e Institutit ka vazhduar prioritetin e tij kryesor: mbështetjen dhe përkrahjen e shoqatave që punojnë për të drejtat dhe integrimin e ish-të përndjekurve politikë, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe përfaqësimin dinjitoz të kësaj kategorie në shoqëri.

IIPP ka ofruar përkrahje të vazhdueshme për shoqatat përfaqësuese, duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre aktive në aktivitete informative, edukative dhe sociale. Këto aktivitete kanë kontribuar në ndarjen e përvojave dhe kërkesave të ish-të përndjekurve politikë, forcimin e lidhjeve ndërmjet shoqatave dhe institucioneve shtetërore, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi vuajtjet dhe të drejtat e tyre.

Aktivitetet e organizuara kanë përfshirë seminare informative dhe takime për mbështetje ligjore dhe administrative, fushata sensibilizuese për të rritur njohjen e të drejtave të ish-të përndjekurve dhe viktimave të regjimeve totalitare, si dhe trajnime për të forcuar kapacitetet e individëve që punojnë me këtë kategori. Një përparësi e veçantë iu kushtua organizimit të eventeve kulturore dhe sociale, të cilat jo vetëm ruajnë kujtesën historike, por promovojnë gjithashtu trashëgiminë kulturore të ish-të përndjekurve politikë.

Përmes këtyre aktiviteteve, IIPP ka mundësuar përforcimin e kapaciteteve institucionale dhe ndihmës së ndërsjellë për shoqatat dhe organizatat e tjera të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të ish-të përndjekurve politikë, duke përfshirë mbështetje financiare, logjistike dhe organizative, si dhe mundësi për krijimin e rrjeteve të reja bashkëpunimi. Një fokus i veçantë ka qenë trajtimi dhe përpjekja për zgjidhjen e çështjeve të papërfunduar të kësaj kategorie, përfshirë dëmshpërblimet financiare, statusin ligjor dhe ndihmën sociale.

Përveç kësaj, aktivitetet kanë krijuar mundësi për të forcuar dialogun ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe përfaqësuesve të shoqatave, duke përmirësuar politikën dhe mbështetjen institucionale ndaj ish-të përndjekurve politikë dhe duke rritur pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën publike dhe shoqërore. Kështu, IIPP ka arritur të bashkojë përpjekjet institucionale dhe komunitare në funksion të promovimit të dinjitetit, të drejtave dhe integrimit të plotë të ish-të përndjekurve politikë në shoqërinë shqiptare.

Aktivitetet Sociale dhe Koordinimi i Projekteve – Viti 2025

Gjatë vitit 2025, sektori i çështjeve sociale ka vijuar të ndërmarrë iniciativa që përgjigjen në mënyrë të menjëhershme ndaj nevojave të familjeve ish të përndjekura politike, duke ofruar mbështetje, kujtim dhe nderim, rehabilitim e aftësim profesional. Njëkohësisht, aktivitetet tona mbartin një mision afatgjatë: të fuqizojnë brezat e rinj të të përndjekurve politikë, duke u mundësuar atyre njohuri, aftësi dhe mundësi për integrim socio-ekonomik të qëndrueshëm. Ky raport pasqyron kombinimin e veprimeve të menjëhershme dhe investimit strategjik në të ardhmen, duke treguar angazhimin tonë për zhvillim të qëndrueshëm dhe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike.

- U zhvillua në Malësi të Madhe aktiviteti përkujtimor në kuadër të shënimit të **80-vjetorit të Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe**, një ngjarje e rëndësishme historike e qëndresës ndaj vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Aktiviteti u organizua nga **Unioni Mbarëkombëtar për Integrimin e të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë** në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të ish Përndjekurve Politikë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave të ish-të përndjekurve politikë, autoriteteve vendore, studiuesve, familjarëve të viktimave dhe qytetarëve. Gjatë aktivitetit u rikujtua se, ndonëse autoritetet komuniste të kohës raportuan vendosjen e kontrollit ushtarak mbi zonën e Shkodrës, në realitet Malësia e Madhe, nga Bajza deri në Vermosh, ishte e organizuar në një qëndresë të gjerë, të udhëhequr nga figura të njohura historike si **Prekë Cali, Major Llesh Marashi dhe Mul Deli Bajraktari**, së bashku me shumë qëndrestarë të tjerë. U theksua se kryengritja u shtyp me mjete represive nga regjimi komunist, duke sjellë humbje të mëdha njerëzore. Si pasojë e këtij represioni, **112 burra dhe gra humbën jetën**, ndërsa dhjetëra të tjerë u ekzekutuan ose u dënuan me burgime dhe internime. Aktiviteti u përmbyll me nderime për martirët dhe qëndrestarët e Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe të vlerave të lirisë dhe demokracisë. Aktivitete të tilla përkujtimore kontribuojnë në **ruajtjen dhe transmetimin e kujtesës historike**, duke ndihmuar shoqërinë të reflektojë mbi pasojat e regjimeve totalitare dhe rëndësinë e vlerave demokratike. Përfshirja e brezave të rinj në këto aktivitete ka një ndikim të drejtpërdrejtë në **formimin e ndërgjegjes qytetare**, duke i njohur ata me ngjarje dhe figura historike që kanë mbrojtur lirinë, dinjitetin njerëzor dhe identitetin kombëtar. Këto iniciativa shërbejnë si instrument edukativ, duke nxitur **dialogun ndërbrezor** dhe duke forcuar lidhjen e të rinjve me historinë dhe trashëgiminë kombëtare. Në nivel shoqëror, aktiviteti ndihmon në **ndërtimin e një kulture kujtese**, e cila promovon drejtësinë historike, respektin për viktimat dhe parandalimin e përsëritjes së fenomeneve represive. Përmes dokumentimit dhe përkujtimit institucional, aktivitete të tilla kontribuojnë në **konsolidimin e vlerave demokratike dhe shtetit të së drejtës**, veçanërisht në edukimin qytetar të brezave të rinj.







- Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë, në kuadër të misionit të tij për ruajtjen e kujtesës historike dhe transmetimin e saj te brezat e rinj, bashkëpunoi me Shoqatën Kombëtare për Rehabilitimin e ish të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë për promovimin e veprës letrare "Filxhani me buzë të kafshuar" të autorit Kadri Tarelli. Vepra letrare *"Filxhani me buzë të kafshuar"* e autorit Kadri Tarelli përbën një kontribut të rëndësishëm në prozën e shkurtër bashkëkohore shqiptare, duke ofruar një qasje të veçantë ndaj përvojës njerëzore dhe kujtesës historike të shoqërisë shqiptare. Libri ndërton një narrativë të përmbajtur, ku përvoja individuale shndërrohet në bartëse të kujtesës kolektive, përmes një gjuhe të thjeshtë, por me ngarkesë të thellë simbolike dhe poetike. Në aspektin e përmbajtjes, tregimet e përmbledhura në këtë vepër trajtojnë tema universale si dashuria, malli, dhimbja, humbja dhe shpresa, të cilat autori i vendos në kontekstin e realitetit shoqëror shqiptar. Ngjarjet dhe përjetimet nuk paraqiten në mënyrë dokumentare apo kronikale, por filtrohen përmes një forme narrative të zbutur, ku detaji i vogël, dialogu i përmbajtur dhe simbolika marrin funksion qendror në ndërtimin e kuptimit. Gjuha e përdorur nga autori karakterizohet nga qartësia, rrjedhshmëria dhe figuracioni i matur. Metafora, ironia e lehtë dhe epiteti shërbejnë si mjete për të përcjellë përvoja të thella emocionale dhe historike, pa i ngarkuar tregimet me retorikë të drejtpërdrejtë. Kjo qasje i jep veprës një dimension poetik të zbutur, përmes të cilit kujtesa historike shfaqet jo si fakt i thatë, por si përjetim njerëzor i përbashkët. Në këtë kuptim, *"Filxhani me buzë të kafshuar"* funksionon si një arkiv i kujtesës shpirtërore, ku përvoja individuale shndërrohet

në dëshmi të heshtur të historisë. Vepra ruan dhe transmeton gjurmë të së kaluarës përmes rrëfimeve të vogla, duke krijuar një hapësirë reflektimi për lexuesin dhe duke ndihmuar në ruajtjen e identitetit kulturor ndër breza. Impakt i veçantë i kësaj vepre qëndron në aftësinë e saj për të komunikuar me brezat e rinj, duke ofruar një formë të aksesueshme dhe të ndjeshme të ballafaqimit me të kaluarën. Përmes poetikës së saj të përmbajtur, libri kontribuon në edukimin kulturor dhe në ndërtimin e një ndërgjegjeje historike të bazuar jo në imponim, por në empati dhe reflektim. Në përfundim, *"Filxhani me buzë të kafshuar"* paraqitet si një vepër me vlera të konsoliduara letrare, kulturore dhe edukative, e cila lë një gjurmë të qëndrueshme në kujtesën historike shqiptare. Përmes një forme narrative të zbutur poetike, Kadri Tarelli arrin të ndërtojë një urë mes përvojës personale dhe kujtesës kolektive, duke konfirmuar rolin e letërsisë si mjet i rëndësishëm i ruajtjes së identitetit dhe trashëgimisë kulturore.



- Instituti i Integrimit të ish Përndjekurve Politikë së bashku me UMIBPPSH organizoi aktivitetin me rastin e 80 vjetorit të gjyqit special ndaj intelektualëve shqiptar të cilësuar si kriminel lufte nga diktatura komuniste. Ky gjyq u zhvillua kryesisht në Kinema Kosova në Tiranë dhe karakterizohej nga mungesa e legjitimitetit dhe shkeljet e rëndësishme të procedurave juridike, duke shërbyer më shumë si instrument politik për eliminimin e kundërshtarëve të regjimit të ri sesa si një proces i drejtë ligjor. Baza ligjore e gjyqit ishte vendimi nr. 26 i Komitetit Antifashist Nacional Çlirimtar dhe Ligji nr. 41 për gjykatat ushtarake, por në praktikë procedurat nuk u ndoqën dhe vendimet u bazuan kryesisht në dëshmi gojore dhe motive politike, ndërkohë që shumë të pandehur nuk kishin kryer krime të provuara. Procesi shfaqte arbitraritet dhe mungesë profesionalizmi juridik, ndërsa

vendimet përfshinin ekzekutime dhe burgime të gjata, shpesh pa bazë ligjore të qartë. Krahasuar me Gjyqin e Nurembergut, Gjyqi Special shqiptar reflektonte një proces me motiv politik të qartë dhe jo një gjykatë me standarde ndërkombëtare. Ky gjyq është dëshmi e rrezikut që paraqet mungesa e institucioneve të pavarura dhe e përdorimit të drejtësisë si mjet politik. Në kuadër të kësaj dite u shfaq dhe një dokumentar ku paraqitet rrëfimi tronditës mbi gjyqin special dhe fillimin e terrorit komunist në ShqipëriRivlerësimi i rasteve dhe dokumentimi i plotë i arkivave janë të domosdoshëm për të siguruar njohjen e së kaluarës dhe për të krijuar një sistem drejtësie më të drejtë dhe të besueshëm. Ky aktivitet kontribuon në ruajtjen e kujtesës historike, njohjen dhe vlerësimin e sakrificave të ish-të përndjekurve politike, dhe forcon bashkëjetesën dhe solidaritetin brenda komunitetit dhe shoqërisë.









- **Aktiviteti "L'uomo che non doveva mai morire"** u realizua në qytetin e Shkodrës me qëllim nxitjen e reflektimit kritik mbi një periudhë të ndjeshme të historisë shqiptare dhe forcimin e kujtesës kolektive, veçanërisht tek të rinjtë. Në fokus të takimit ishin reflektimet mbi vëllimin që trajton një segment të rëndësishëm të historisë së Shqipërisë, duke u ndalur te njëzet vitet e fundit të jetës së Enver Hoxhës deri në vdekjen e tij. Rrugëtimi historik u ndërtua mbi informacione të dokumentuara dhe dëshmi të mbledhura nga autori, duke ofruar një pasqyrë analitike mbi funksionimin e regjimit diktatorial, gjyqet pa bazë ligjore dhe mekanizmat e represionit shtetëror. Diskutimi i zhvilluar mes autorit, gazetarit Giovanni Verga, dhe pjesëmarrësve krijoi hapësirë për analizë kritike mbi ndikimin e kësaj

periudhe në zhvillimin politik, shoqëror dhe kulturor të vendit. Aktiviteti synoi të kontribuojë në ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi pasojat e autoritarizmit dhe rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike, si një mjet edukues për parandalimin e përsëritjes së situatave të ngjashme në të ardhmen. Realizimi i këtij aktiviteti në Shkodër pati një impakt të dukshëm në përfshirjen e të rinjve në debat publik dhe në nxitjen e dialogut mbi vlerat demokratike, duke lënë gjurmë të qëndrueshme në memorien e tyre kolektive.



- Promovimi i librit "Ëndrra për jetën" u zhvillua në qytetin e Pogradecit dhe përbën një aktivitet me vlerë të veçantë kulturore dhe memoriale, kushtuar dëshmisë letrare të përvojës së persekutimit politik gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri. Aktiviteti u organizua nga organizata "Të Përndjekurit.al", me mbështetjen e Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë. Libri i autores Rozeta (Duro) Rexhollari sjell një rrëfim autobiografik që pasqyron dimensionin njerëzor të dhunës shtetërore dhe pasojat e saj afatgjata mbi individin dhe familjen. Autorja, e lindur në qytetin e Korçës, përjetoi që në fëmijëri trauma të thella si pasojë e ekzekutimit të të atit nga regjimi diktatorial në vitin 1949, kur ajo ishte vetëm 10 vjeçe. Pas kësaj ngjarjeje, familja e saj u përball me vite të

gjata internimi dhe vuajtjesh, që lanë gjurmë të pashlyeshme në formimin e saj personal dhe intelektual. Pas vitit 1992, autorja u bë pjesë aktive e jetës letrare, duke kontribuar në antologjitë e krijuesve të persekutuar nga terrori komunist, si një formë rikthimi të zërit të mohuar për dekada me radhë. Botimi "Ëndrra për jetën" përfaqëson jo vetëm një vepër letrare, por edhe një dokument dëshmues të rezistencës shpirtërore dhe të përpjekjes për dinjitet njerëzor në kushte ekstreme represioni. Aktiviteti synoi të forcojë ndërgjegjësimin, veçanërisht tek brezat e rinj, mbi pasojat e totalitarizmit dhe rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike si një element thelbësor i edukimit qytetar dhe i ndërtimit të një shoqërie demokratike.





- Shoqata Kombëtare për Integrimin dhe Rehabilitimin e Ish-të Burgosurve dhe Përndjekurve Politikë të Shqipërisë – Durrës, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë, realizoi një ekspozitë përkujtimore dhe dokumentuese kushtuar ish-të burgosurve politikë, personave të pushkatuar, individëve të vdekur në institucionet e vuajtjes së dënimit, si dhe ish-të internuarve politikë të qarkut Durrës, viktima të represionit të ushtruar nga regjimi komunist në Shqipëri. Ky aktivitet u konceptua si pjesë e ndërhyrjeve strategjike për ruajtjen, dokumentimin dhe transmetimin

e kujtesës historike, duke vlerësuar nevojshmërinë e adresimit të së kaluarës totalitare si një komponent thelbësor i procesit të edukimit qytetar dhe të konsolidimit demokratik. Ekspozita ofroi një qasje gjithëpërfshirëse mbi format e persekutimit politik, duke evidentuar shkeljet sistematike të të drejtave themelore të njeriut dhe pasojat e tyre afatgjata në nivel individual, familjar dhe shoqëror. Përmes përdorimit të materialeve arkivore, dokumenteve historike, dëshmive personale dhe elementeve vizuale, aktiviteti krijoi një hapësirë reflektimi dhe ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, duke kontribuar në forcimin e kulturës së kujtesës dhe të drejtës për të vërtetën. Vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së brezave të rinj, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi pasojat e autoritarizmit dhe rëndësinë e respektimit të vlerave demokratike. Realizimi i ekspozitës shërbeu gjithashtu si një mjet edukues dhe parandalues, duke theksuar domosdoshmërinë që përvoja historike e persekutimit politik të integrohet në diskursin publik dhe në memorien kolektive, me qëllim që praktika të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Aktiviteti pati një impakt të matshëm në rritjen e interesit dhe angazhimit të të rinjve në diskutime mbi historinë e afërt dhe përgjegjësinë qytetare, duke kontribuar në ndërtimin e një narrative të qëndrueshme mbi drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin shoqëror.



- **Shoqata Kombëtare për Integrimin dhe Rehabilitimin e Ish-të Burgosurve dhe Përndjekurve Politikë të Shqipërisë – Durrës**, në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të **Institutit për Integrimin e Ish-të Përndjekurve Politikë**, realizoi botimin

e librit me karakter dokumentues dhe përkujtimor me titull **“Libër Faktesh”**, kushtuar ish-të burgosurve politikë të qarkut Durrës, viktima të represionit të regjimit komunist. Ky botim përfaqëson një ndërhyrje me rëndësi të veçantë në kuadër të politikave të kujtesës dhe të drejtës për të vërtetën, duke synuar dokumentimin sistematik të emrave, historive dhe fateve të individëve që u persekutuan, u burgosën, u pushkatuan, humbën jetën në burgje apo u internuan për arsye politike. Përmbajtja e librit mbështetet në të dhëna historike, dëshmi dhe burime arkivore, duke e kthyer atë në një referencë të vlefshme për studiuesit, institucionet dhe publikun e gjerë. Libri është konceptuar jo vetëm si një akt përkujtimi dhe nderimi për viktimat dhe familjet e tyre, por edhe si një instrument edukues për brezat e rinj, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi pasojat e totalitarizmit dhe shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste. Dimensioni memorial i botimit, i shoqëruar me elementë letrarë dhe simbolikë, kontribuon në forcimin e memorien kolektive dhe në transmetimin ndërbrezor të së kaluarës historike. Realizimi i këtij botimi vlerëson nevojshmërinë e ruajtjes së kujtesës historike si pjesë integrale e procesit të drejtësisë tranzicionale, pajtimit shoqëror dhe konsolidimit të vlerave demokratike. “Libër Faktesh” përbën një dëshmi të qëndrueshme dokumentare dhe një kontribut afatgjatë në ndërtimin e një narrative të përgjegjshme mbi krimet e komunizmit, duke synuar që ngjarje të tilla të mos harrohen dhe të mos përsëriten më kurrë.



- Shqipëria ka përjetuar një nga diktaturat më të egra dhe represive të Europës, e cila la pasoja të thella dhe afatgjata në jetën politike, shoqërore dhe kulturore të vendit. Në këtë kontekst historik, Instituti i Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë, duke u nisur nga misioni i tij themelor për ruajtjen dhe transmetimin e kujtesës kolektive mbi kalvarin e vuajtjeve dhe krimet e komunizmit, vendosi të bashkëpunojë me Unionin Mbarëkombëtar të Integrimit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë (UMIBPPSH) për realizimin e një dokumentari audioviziv. Dokumentari ka në fokus dëshmitë e drejtpërdrejta të të mbijetuarve të Kampit famëkeq të Spaçit, një nga simbolet më të errëta të represionit komunist në Shqipëri. I ndërtuar mbi filozofinë “Dëshmoj për të kujtuar”, ky projekt synon të sjellë para publikut rrëfime autentike dhe të detajuara mbi kushtet çnjerëzore të jetesës, format e dhunës sistematike, si dhe aktet e rezistencës dhe dinjitetit njerëzor që u manifestuan brenda këtij kampi. Një vëmendje e veçantë i kushtohet Revoltës së Spaçit, e cila ka hyrë në histori si një nga aktet më të fuqishme të rezistencës kolektive

në kampet dhe burgjet e komunizmit në Europën Juglindore. Kjo ngjarje përfaqëson një moment kulmor të qëndresës morale dhe politike ndaj diktaturës, duke dëshmuar se, edhe në kushtet më ekstreme të shtypjes, aspirata për liri dhe dinjitet nuk mund të asgjësohej. Dokumentari do të publikohet në të gjitha platformat online, me qëllim që të jetë i aksesueshëm për një audiencë të gjerë, veçanërisht për brezat e rinj. Ai synon të mbetet një dokument historik me vlerë të qëndrueshme, që kontribuon në ndërgjegjësimin publik mbi karakterin gjenocidal të regjimit diktatorial dhe pasojat e tij mbi shoqërinë shqiptare. Njëkohësisht, rrëfimet e të mbijetuarve nxjerrin në pah edhe dimensionin e paqes, maturisë dhe përgjegjësisë qytetare që këta individë treguan gjatë periudhës së tranzicionit demokratik, duke ofruar një shembull të rëndësishëm për ndërtimin e pajtimit shoqëror dhe të kulturës së dialogut. Në këtë mënyrë, dokumentari përbën jo vetëm një akt kujtese, por edhe një mjet edukimi dhe reflektimi për të ardhmen demokratike të vendit.



- **Tingujt e Kujtesës 2025, Homazh për martirët e Spaçit dhe viktimat e regjimit komunist në Shqipëri.** Edicioni i katërt i aktivitetit përkujtimor **"Tingujt e Kujtesës"** u përmbyll me një koncert memorial të zhvilluar për herë të parë në territorin e ish-burgut famëkeq të Spaçit, një nga simbolet më të dhunës dhe represionit të regjimit komunist në Shqipëri. Ky aktivitet përkoi me 52-vjetorin e kryengritjes së të burgosurve politikë të Spaçit, e cila përfaqëson aktin e parë dhe të vetëm të rezistencës së organizuar brenda kampeve të internimit dhe burgjeve politike gjatë diktaturës. Koncerti përkujtimor u konceptua si një akt simbolik dhe memorial, duke rikthyer këtë hapësirë të dhunës dhe vuajtjes në një vend reflektimi, nderimi dhe ndërgjegjësimi kolektiv. Përmes gjuhës universale të artit dhe muzikës, aktiviteti synoi të dënojë krimet e regjimit komunist, të nderojë qëndresën dhe sakrificën e të burgosurve politikë, si dhe të kontribuojë në forcimin e kulturës së kujtesës në shoqërinë shqiptare. Në aktivitet morën pjesë ish-të burgosur politikë të Spaçit, të përndjekur politikë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, të cilët ritheksuan rëndësinë e përballjes së shoqërisë shqiptare me të kaluarën e saj totalitare si një kusht thelbësor për konsolidimin e demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e një narrative të bazuar në të vërtetën historike. Aktiviteti u organizua nga Kujto.al, me mbështetjen e Fondacionit

Konrad Adenauer, Institutit të Integrimit të ish Përndjekurve Politikë, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP). Realizimi i këtij edicioni përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në politikat e kujtesës dhe në proceset e drejtësisë tranzicionale, duke pasur një impakt të ndjeshëm në ndërgjegjësimin e publikut, veçanërisht të brezave të rinj, mbi pasojat e totalitarizmit dhe rëndësinë e ruajtjes së memories historike për të mos lejuar përsëritjen e këtyre krimeve në të ardhmen.



- DITËT E KUJTESËS – Edicioni Rinor, u zhvillua në sallën e konferencave të Hotel Rogner në Tiranë dhe u konceptua si një ndërhyrje strategjike në kuadër të objektivit institucional për forcimin e edukimit qytetar dhe ndërgjegjësimit historik të brezave të rinj. Në themel të ideimit të aktivitetit qëndroi thënia e shkrimtarit Nedo Fiano: "Ai që harron bëhet palë me vrasësit", e cila shërbeu si bosht etik dhe referencë reflektuese për përmbajtjen e diskutimeve. Aktiviteti u organizua nga "Të Përndjekurit.al", me mbështetjen e Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë, dhe përfshiu ish-të përndjekur politikë, të rinj që vijnë nga familje të kësaj shtrese, personalitete të jetës publike dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Nëpërmjet ndarjes së përjetimeve autentike dhe dëshmive personale, aktiviteti krijoi një hapësirë dialogu ndërbrezor, duke ofruar për të rinjtë një formë të drejtpërdrejtë të edukimit qytetar dhe historik. Këto rrëfime u vlerësuan si mjete të fuqishme ndërgjegjësuese, që kontribuojnë në formimin e një kulture

kritike ndaj pushtetit, në forcimin e integritetit moral dhe në kuptimin e vlerës së lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Në aspektin e impaktit rinor, aktiviteti kontribuoi në: rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të të rinjve mbi pasojat e diktaturës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut; forcimin e aftësisë së të rinjve për të reflektuar në mënyrë kritike mbi pushtetin, autoritarizmin dhe përgjegjësinë qytetare; promovimin e vlerave të lirisë, dinjitetit njerëzor dhe angazhimit demokratik si elemente thelbësore të pjesëmarrjes aktive në shoqëri; nxitjen e interesit të të rinjve për ruajtjen dhe transmetimin e kujtesës historike si një komponent i rëndësishëm i identitetit qytetar. Instituti i Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë vlerësoi këtë aktivitet si një praktikë të mirë në fushën e edukimit joformal dhe të politikave të kujtesës, duke theksuar se iniciativa të tilla përbëjnë investime strategjike afatgjata për formimin e brezave të rinj dhe për parandalimin e relativizimit apo harrimit të krimeve të regjimeve totalitare. "Ditët e Kujtesës – Edicioni Rinor" u konsolidua si një platformë edukative dhe reflektuese që kontribuon drejtpërdrejt në objektivat strategjikë të organizatës në fushën e edukimit, rinisë dhe kujtesës historike, duke lënë një impakt të qëndrueshëm në formimin qytetar të pjesëmarrësve dhe në ndërtimin e një shoqërie të ndërgjegjshme dhe demokratike.







- Shoqata e Unionit Mbarëkombëtar të Integrimit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë (IIPP), ICMP dhe Fondacionin Konrad Adenauer, në kuadër të Misionit Kombëtar "Demokracia

nuk ndërtohet mbi Harresën", ka realizuar dokumentarin televiziv mbi revoltën antikomuniste të Spaçit të vitit 1973, me titull "Martirët e Lirisë". Ky projekt përbën një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e kujtesës historike kombëtare, duke evidentuar sakrificat dhe qëndresën heroike të të burgosurve politikë, si dhe dimensionin ndërkombëtar të ngjarjes së 21 Majit 1973. Promovimi i dokumentarit u zhvillua në Kinema Millenium dhe shënoi një moment të veçantë në përpjekjet për të konsoliduar kujtesën kolektive të kombit. Ky aktivitet nuk ishte thjesht një ngjarje kulturore, por një përpjekje e strukturuar për të evidentuar rëndësinë e revoltës së Spaçit si datë historike në kalendarin e kujtesës kombëtare, duke nxjerrë në pah figurat e qëndresës dhe sakrificës, të cilat përbëjnë shembuj të qëndrueshmërisë morale dhe patriotizmit në përballje me represionin totalitar. Dokumentari fokusohet kryesisht tek dëshmitë e të mbijetuarve të revoltës dhe të periudhës së burgosjes në Spaç, duke u mbështetur gjithashtu në dokumente arkivore dhe botime shkencore që pasqyrojnë realitetin e asaj periudhe. Përmes kombinimit të kujtesës orale dhe burimeve historike të verifikuara, filmi ofron një pasqyrë të plotë dhe të detajuar të një ngjarjeje me përmasa jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare, duke kontribuar në edukimin dhe ndërgjegjësimin historik të qytetarëve. Ky event promovues solli emocione të forta tek pjesëmarrësit dhe përfshiu fjalime të të ftuarve dhe ish-të përndjekurve politikë, të cilët ndanë përvojat e tyre të vuajtjeve dhe torturave gjatë regjimit komunist. Përmes këtyre aktiviteteve, Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politik dhe partnerët e tij nënvizojnë rëndësinë e investimit në projekte të tilla për të lënë gjurmë të prekshme tek brezat e rinj, duke forcuar ndërgjegjësimin qytetar dhe vlerësimin e lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Në veçanti, dokumentari "Martirët e Lirisë" do të promovojë dhe shfaqet në media kombëtare, duke garantuar një përhapje më të gjerë të mesazhit të tij edukativ dhe historik. Kjo shtrirje mediatike siguron që historia e revoltës së Spaçit të mos mbetet vetëm në kujtesën e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë, por të arrijë tek brezat e rinj dhe publiku i gjerë, duke forcuar rëndësinë e kujtesës historike si një mjet i domosdoshëm për edukimin qytetar dhe konsolidimin e vlerave demokratike në Shqipëri.







- Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politik të Shqipërisë kërkoi mbështetje nga IIPP për të organizuar më 20-25 Qershor 2025 një aktivitet në kujtesë dhe mbrojtje të Burgut të Spaçit, duke evidentuar rëndësinë e tij historike dhe angazhimin për ruajtjen e kujtesës kombëtare. Burgu i Spaçit, një burg politik i sigurisë së lartë gjatë diktaturës komuniste, është shpallur Monument Kulture i kategorisë së parë me Vendimin nr. 656, datë 5 Dhjetor 2007, duke e pozicionuar si një nga vendet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në Shqipëri. Sipas vendimit nr. 600, datë 06.12.2024, të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, disa ndërhyrje të kryera në objektet e Burgut dukshëm dëmtojnë autenticitetin dhe karakterin historik të tij. Ruajtja e Burgut të Spaçit e pandryshuar është një detyrim moral dhe kombëtar ndaj të gjithë atyre që vuajtën aty, si dhe një përgjegjësi ndaj brezave të ardhshëm. Çdo ndërhyrje duhet të realizohet vetëm me standarde profesionale, transparencë dhe konsultim me institucionet kulturore, historianë dhe ish-të përndjekur politikë, për të garantuar mbrojtjen e vlerës historike dhe kulturore të këtij vendi simbolik.



- Sami Dangëllia vdiq në moshën 61-vjeçare, pas një vuajtjeje të gjatë prej 43 vjetësh në burg, afërsisht dyfishit të periudhës së burgosjes së Nelson Mandelës. Ai ndërroi jetë më 23 Prill 1987, në orën 23:00, ndërsa varrimi u krye brenda murave të burgut, pa praninë e të tjerëve dhe pa asnjë informacion mbi vendin e varrimit. Instituti i Integrimit të Ish-Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Shoqatën Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë Demokrat Devoll, përkujtuan rastin e 105-vjetorit të lindjes së këtij antikomunisti legjendar në Menkulas, Devoll. Ky përkujtim nuk synon të kujtohet vetëm nga miqtë dhe bashkëvuajtësit, të cilët nuk mund ta harrojnë kurrë, por ka një domosdoshmëri edukative dhe morale: Sami Dangëllia dhe shokët e tij përfaqësojnë vlera njerëzore të çmuara, pa të cilat brezat e rinj mund të mos arrijnë të kuptojnë rëndësinë dhe ekzistencën e diktaturës komuniste gjysmëshekullore në Shqipëri. Ruajtja e kujtesës së tyre është një mjet thelbësor për të forcuar ndërgjegjësimin historik dhe moral të shoqërisë shqiptare. Përkujtimi i Sami Dangëllisë përbën një domosdoshmëri për historin e shoqërisë shqiptare.





- Unioni Mbarëkombëtar i Ish-të Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe diasporën amerikane të Kelmendit, organizoi në Vermosh të Malësisë së Madhe aktivitetin përkujtimor me rastin e 80-vjetorit të vrasjes së Prekë Calit dhe 13 burrave të tjerë, të ekzekutuar më 25 mars 1945 nga regjimi komunist. Kjo ngjarje historike njihet si Kryengritja e Malësisë së Madhe kundër diktaturës komuniste, një nga aktet më domethënëse të rezistencës antikomuniste në Shqipërinë e pasluftës. Gjatë aktivitetit, historiani dhe profesori Edmond Malaj theksoi se Beteja e Tamarës përfaqëson një moment kyç të luftës civile shqiptare dhe një nga episodet më të dhimbshme të historisë sonë kombëtare. Ai vlerësoi figurën e Prekë Calit si një nga personalitetet më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke nënvizuar rolin e tij në mbrojtje të identitetit, lirisë dhe dinjitetit kombëtar. Prekë Cali u pushkatua më 25 mars 1945, pas një dënimi me vdekje nga regjimi komunist, ndërsa popullsia e Malësisë së Madhe u përball për dekada me radhë me represion të vazhdueshëm, përfshirë vrasje, tortura dhe dënime të rënda që zgjatën për rreth 45 vite. Aktiviteti përkujtimor vijoi me një program artistik, ku morën pjesë artistë të zonës së Malësisë së Madhe, duke i dhënë aktivitetit një dimension kulturor dhe simbolik, në funksion të ruajtjes së kujtesës historike dhe përcjelljes së saj tek brezat e rinj.





- Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të Ish-Përndjekurve Politikë (IIPP), organizoi në qytetin e Tropojës, një aktivitet përkujtimor në nderim të viktimave të diktaturës komuniste. Ky aktivitet u zhvillua në një trevë me histori të spikatur qëndrese, për t'u përulur me respekt të thellë përpara kujtimit të atyre që u vranë, u burgosën, u dëbuan dhe u internuan nga regjimi komunist, por që nuk u nënshtruan kurrë në shpirt dhe në ndërgjegje. Në këtë ditë u përkujtuan me dhimbje dhe krenari Fet Sadiku dhe Uke Quni, dy martirë të pushkatuar pa gjyq më 29 shtator 1946 në Lekbibaj, në prani të rreth 2000 burrave, vetëm për faktin se mbetën të lirë në mendim dhe në shpirt. Përmes figurës së tyre u nderuan edhe 1121 të përndjekur dhe të sakrifikuar deri në vdekje, nga Qafa e Agrit deri në Qafë Morinë, duke përfaqësuar simbolikisht të gjitha viktimat e Malësisë së Gjakovës.Bilanci i persekutimit në këtë trevë përfshin: 198 persona të pushkatuar, shumë prej tyre pa asnjë proces gjyqësor; qindra të burgosur politikë, të dënuar në kushtet çnjerëzore të burgjeve të diktaturës; qindra familje të internuara dhe të dëbuara, me shumë viktima që humbën jetën në kampet e përqendrimit dhe të punës së detyruar, duke jetuar për vite me radhë në kushte përjashtimi, harrese dhe përçmimi. Malësia e Gjakovës ka mbajtur mbi supe një nga barrët më të rënda të persekutimit politik në Shqipëri dhe, pavarësisht kësaj, nuk ka kërkuar asgjë tjetër përveç drejtësisë, njohjes dhe së vërtetës historike. Ruajtja e kësaj kujtese përbën një detyrim moral dhe kombëtar ndaj viktimave dhe një domosdoshmëri për ndërgjegjen demokratike të shoqërisë shqiptare.





- Shoqata Kombëtare për Integrimin dhe Rehabilitimin e Ish-të Burgosurve Politikë të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin për Integrim dhe Politika Publike (IIPP), zbatoi projektin **"Shporta e Dinjitetit"**, si një ndërhyrje e drejtpërdrejtë sociale në mbështetje të familjeve të përndjekura politikisht që ndodhen në kushte të theksuara vështirësie ekonomike dhe sociale. Projekti u konceptua si përgjigje ndaj nevojave emergjente të kësaj kategorie, të cilat janë përkeqësuar si pasojë e moshës së avancuar të përfituesve, problemeve të shumta shëndetësore dhe pamundësisë për të siguruar të ardhura të qëndrueshme. Shumë prej familjeve të synuara përbëhen nga individë të moshuar, shpesh

me sëmundje kronike, për të cilët përballimi i shpenzimeve bazë të jetesës përbën një barrë të konsiderueshme. Në këtë kontekst, projekti u realizua përmes shpërndarjes së ndihmave ushqimore dhe produkteve higjieno-sanitare, duke adresuar nevoja thelbësore dhe imediate të përfituesve. Ndërhyrja pati një impakt të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës së familjeve të përndjekura politikisht, duke lehtësuar përkohësisht pasigurinë ushqimore dhe vështirësitë e lidhura me kujdesin bazë shëndetësor dhe higjienik. Përtej aspektit material, projekti **"Shporta e Dinjitetit"** mbart një dimension të rëndësishëm simbolik dhe shoqëror, duke synuar rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur të një kategorie që historikisht ka vuajtur. Kjo nismë përfaqëson një hap konkret drejt njohjes dhe mbështetjes së qëndrueshme të të përndjekurve politikë, duke afirmuar parimet e drejtësisë sociale, solidaritetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.



- Në kuadër të politikave të integrimit dhe në përgjigje të nevojave imediate për punësim të qëndrueshëm, Instituti ka mbështetur nisma konkrete për **kualifikimin profesional të fëmijëve të ish-të përndjekurve politikë**, me qëllim rritjen e mundësive të tyre për

integrim ekonomik dhe social afatgjatë. Në këtë kontekst, u mbështet projekti për hapjen e një **kursë Gjermanisht – Anglisht**, me kohëzgjatje **3-mujore**. Këto programe u organizuan nga **Shoqata Kombëtare për Integrimin dhe Rehabilitimin e ish të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë – Dega Durrës**, dhe synuan drejtpërdrejt **integrimin dhe rehabilitimin socio-ekonomik të familjarëve të ish-të përndjekurve politikë**. Ofrimi i këtij programi trajnimi u fokusua në sigurimin e **cilësisë së lartë të mësimdhënies**, duke u bazuar në trajnerë me përvojë dhe kurrikula të përshtatura me kërkesat aktuale të tregut të punës. Instituti i të Përndjekurve Politikë, ndër vite, në bashkëpunim me shoqata dhe aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, i ka dhënë prioritet ofrimit të një **game të gjerë kursesh profesionale**, duke përfshirë fusha si arsimi, teknologjia, dizajni grafik, komunikimi dhe shërbimet. Ky qasje strategjike synon fuqizimin e të rinjve përmes zhvillimit të aftësive të kërkuara në treg, duke i pajisur ata me mjete konkrete për ndërtimin e një të ardhmeje të pavarur. Kurset profesionale përbëjnë një **investim të rëndësishëm në kapitalin njerëzor**, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të të rinjve dhe në përputhjen e tyre me nevojat e tregut të punës. Përvoja ka treguar se pjesëmarrësit në këto programe kanë më shumë mundësi për të siguruar punësim më të mirëpaguar dhe me perspektiva zhvillimi, falë aftësive specifike të fituara gjatë trajnimit. Në këtë kuptim, mbështetja e aftësimit profesional për fëmijët e ish-të përndjekurve politikë përfaqëson një **investim afatgjatë në integrimin e tyre shoqëror dhe ekonomik**, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës dhe në forcimin e kohezionit social.



- Ekspozita **“Maska që zbulojnë”** u zhvillua në ambientet e dikurshme të administratës së ish-Burgut të Spaçit, një hapësirë me ngarkesë të thellë historike dhe simbolike, e cila përmes këtij instalacioni u shndërrua në një vend reflektimi, kujtese dhe dialogu publik. Në këtë mjedis, ku dikur dominonte gjuha e urdhrit dhe kontrollit, sot u rikthyen fytyrat e së shkuarës në formën e maskave—të qeta, të ngrira dhe pa fjalë—por njëkohësisht thellësisht komunikuese. Maskat, të realizuara për së gjalli nga ish-personeli i burgut, nuk funksionojnë si mjete fshehjeje, por si instrumente zbuluese. Ato përballen drejtpërdrejt me vizitorin, pa truk estetik dhe pa justifikime morale, duke krijuar një marrëdhënie të sinqertë dhe të drejtpërdrejtë me të shkuarën. Përmes dëshmive autentike audio që shoqërojnë portretet, ekspozita ndërton një narrativë të heshtur, por të fuqishme, ku secili zë shpalos përvojën e vet përtej ndjenjave të turpit, fajit apo pendesës. Në këtë kontekst, e shkuara nuk paraqitet si një realitet që kërkon zbukurim, por si një histori që kërkon njohje, përballje dhe kujtesë kolektive. Në kuadër të aktivitetit **“Përtej Maskave – Portrete dhe**

Kujtime”, i organizuar nga **Tek Bunkeri** brenda projektit **SHPIRTERIM**, ish-Burgu i Spaçit u shndërrua në një hapësirë të gjallë ndërveprimi kulturor dhe shoqëror, duke mbledhur qindra pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria. Përveç ekspozitës **“Maskat që Zbulojnë”**, aktiviteti përfshiu një sërë komponentësh artistikë dhe edukativë që synonin thellimin e dialogut mbi trashëgiminë e dhimbshme të së shkuarës. Libri **“Terrene – Tetë Vështrime mbi Spaçin”** kontribuoi në analizën kritike dhe shumëdimensionale të historisë së Spaçit, duke theksuar rëndësinë e vazhdimësisë së debatit publik mbi kujtesën historike. Filmi i animuar **“ANTIMUZEU”** eksploroi konceptet e lirisë, ëndrrave dhe rezistencës përmes një gjuhe simbolike dhe bashkëkohore, ndërsa **Biblioteka Njerëzore** krijoi mundësi të rralla për shkëmbime ndërbrezash, duke nxitur mirëkuptim, empati dhe reflektim të ndërsjellë. Ky aktivitet u realizua me mbështetjen e programit të granteve **EU4Culture**, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga **UNOPS**, në partneritet me **Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit** dhe **Institutin e Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë**. Ekspozita dhe aktivitetet shoqëruese përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e kujtesës kolektive, në promovimin e dialogut shoqëror dhe në ndërtimin e një të ardhmeje më të vetëdijshme dhe më gjithëpërfshirëse.



- Konferenca **“Falje dhe Drejtësi”** u organizua si një nismë që synon të vendosë në qendër të vëmendjes publike zërin, dinjitetin dhe të drejtat e ish-të përndjekurve politikë në Shqipëri. Ky aktivitet u konceptua si një platformë reflektimi dhe dialogu mbi trashëgiminë e dhimbshme të së shkuarës, si dhe mbi domosdoshmërinë e ndërtimit të një qasjeje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse ndaj drejtësisë tranzicionale. Konferenca mblodhi së bashku krerë dhe përfaqësues të shoqatave të ish-të përndjekurve politikë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, personalitete publike, juristë, sociologë, si dhe përfaqësues të klerit në Shqipëri, shumë prej të cilëve kanë përjetuar drejtpërdrejt përndjekjen dhe represionin e regjimit komunist. Përmes diskutimeve të strukturuara dhe dëshmive personale, pjesëmarrësit kontribuan në ndërtimin e një debati të thelluar mbi

rëndësinë e faljes, drejtësisë dhe kujtesës historike si shtylla themelore për pajtimin shoqëror dhe forcimin e demokracisë. Nëpërmjet këtij aktiviteti, u synua përcjellja e një mesazhi të qartë reflektimi dhe bashkimi, duke theksuar se falja nuk mund të konceptohet pa njohjen e së vërtetës dhe pa garantimin e drejtësisë për viktimat e së kaluarës. Diskutimet nënvizuan nevojën për trajtim dinjitoz dhe të qëndrueshëm institucional ndaj të mbijetuarve të persekutimit politik, si dhe përgjegjësinë për ruajtjen e kujtesës kolektive për brezat e ardhshëm. Në përfundim të konferencës, u miratua dhe u nënshkrua një deklaratë e përbashkët, e cila do t'i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë, partive politike dhe institucioneve përkatëse shtetërore. Deklarata kërkon rivlerësimin e skemave të dëmshpërblimit, përmirësimin e politikave të trajtimit social dhe shëndetësor të ish-të përndjekurve politikë, si dhe hartimin e masave konkrete për mbështetjen e brezave pasardhës, me qëllim që padrejtësitë e së kaluarës të adresohen në mënyrë të drejtë dhe përfundimtare. Konferenca **"Falje dhe Drejtësi"** u zhvillua me iniciativën e organizatës **TEPERNDJEKURIT.AL**, me mbështetjen e **Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë**, dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të dialogut institucional dhe shoqëror mbi drejtësinë, kujtesën dhe pajtimin në Shqipëri.





- Botim i librit **"Të munda, diktaturë!"**, me autorësi të Bajame Hoxha Çeliku dhe me mbështetjen e **Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP)**, synon dokumentimin dhe përcjelljen artistike të përvojës së persekutimit politik gjatë regjimit komunist në Shqipëri, përmes letërsisë dëshmuese në poezi dhe prozë. Vepra përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e kujtesës historike dhe në fuqizimin e zërit të grave dhe familjeve të përndjekura politikisht. Libri mbështetet në rrëfimin autobiografik të autores, e cila përmes gjuhës poetike dhe narrative pasqyron realitetin e jetës në kushte represioni ekstrem, duke sjellë në vëmendje përvojat e grave, nënave dhe fëmijëve që kanë përjetuar burgosjen, internimin dhe përjashtimin shoqëror. Përmes këtij projekti, përvoja individuale shndërrohet në dëshmi kolektive, duke i dhënë zë një kategorie që historikisht ka qenë e margjinalizuar dhe e privuar nga e drejta për të rrëfyer historinë e saj. Qëllimi kryesor i projektit është afirmimi i së vërtetës historike përmes artit, si dhe promovimi i reziliencës njerëzore përballë dhunës dhe padrejtësisë institucionale. Libri synon të sfidojë narrativën e heshtjes rreth viktimave të diktaturës, duke theksuar se dëshmia artistike

përbën një mjet të rëndësishëm për drejtësinë morale, reflektimin shoqëror dhe edukimin e brezave të rinj. Projekti ka një vlerë të veçantë kulturore dhe shoqërore, pasi trajton dimensionin gjinor të persekutimit politik, duke nxjerrë në pah rolin e gruas si mbartëse e kujtesës, mbijetesës dhe transmetimit të vlerave njerëzore në kushte ekstreme. Përmes poezisë dhe prozës, vepra ndërton një hapësirë dialogu midis së shkuarës dhe së tashmes, duke kontribuar në proceset e kujtesës kolektive dhe pajtimit shoqëror. Në këtë kuadër, **"Të munda, diktaturë!"** përfaqëson jo vetëm një vepër letrare, por edhe një akt kulturor dhe etik, që synon të parandalojë harresën dhe të nxisë një ndërgjegjësim të qëndrueshëm mbi pasojat e diktaturës. Projekti kontribuon drejtpërdrejt në misionin e IIPP për integrimin, rehabilitimin dhe përfaqësimin dinjitoz të ish-të përndjekurve politikë në jetën kulturore dhe shoqërore të vendit.



- Në kuadër të **50-vjetorit të Revoltës Antikomuniste të të Burgosurve Politikë në ish-Burgun e Spaçit**, Unioni Mbarëkombëtar i të Përndjekurve Politikë me mbështetjen e **Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë** organizoi një aktivitet përkujtimor në **Reç të Malësisë së Madhe**, një vend me domethënie të veçantë historike dhe simbolike për qëndresën antikomuniste. Ky aktivitet u zhvillua me synimin për të nderuar sakrificën, guximin dhe rezistencën e të burgosurve politikë që u ngritën kundër represionit të regjimit komunist, duke e kthyer revoltën e Spaçit në një nga aktet më të rëndësishme të qëndresës së hapur në historinë e diktaturës në Shqipëri. Veprimtaria mblodhi së bashku ish-të përndjekur politikë, përfaqësues të shoqatave të tyre, familjarë të viktimave, si dhe përfaqësues të institucioneve dhe të shoqërisë civile. Përmes fjalimeve përkujtimore dhe dëshmive personale, u rikujtua rëndësia historike e revoltës së Spaçit si një akt i jashtëzakonshëm guximi dhe si simbol i aspiratës për liri, dinjitet dhe drejtësi. Aktiviteti shërbeu gjithashtu si një thirrje për ruajtjen e kujtesës historike dhe për nevojën e reflektimit të vazhdueshëm institucional dhe shoqëror mbi krimet e komunizmit, në mënyrë që sakrifica e atyre që u përballën me persekutimin të mos harrohet dhe të përcillet te brezat e ardhshëm si një mësim themelor mbi vlerat e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.



- U zhvillua takimi kulturor dhe letrar kushtuar figurës së **Uran Kostrecit**, i organizuar nga **TePerndjekurit.al**, me mbështetjen e **Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP)**. Aktiviteti u konceptua si një hapësirë reflektimi dhe vlerësimi për një personalitet që përfaqëson lirinë e mendimit, integritetin intelektual dhe qëndresën morale përballë represionit të regjimit komunist. Takimi bëri bashkë miq, dashamirës, ish-të përndjekur politikë dhe ish-të burgosur të ndërgjegjes, përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të lidhura me çështjen e të përndjekurve politikë, përfaqësues të spektrit politik, si dhe një përfaqësuese të Misionit të OSBE-së në Shqipëri. Prania e gjerë dhe e larmishme e pjesëmarrësve kontribuoi në krijimin e një dialogu gjithëpërfshirës mbi vlerën e kujtesës historike dhe rolin e figurave intelektuale në mbrojtjen e lirive themelore. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, u shfaq një mini-dokumentar me përmbledhje nga jeta dhe veprimtaria e Uran Kostrecit, i cili pasqyroi në mënyrë sintetike kontributin e tij letrar dhe qytetar. Programi u pasurua me recitime të vargjeve nga krijimtaria e tij, si dhe me ndarjen e thënieve dhe fragmenteve nga daljet e tij publike dhe mediatike, të cilat reflektojnë qartë qëndrimin e tij intelektual dhe etik. Një moment i veçantë i takimit ishte video-mesazhi i dërguar nga dy mbesat e z. Kostreci nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat ndanë kujtime personale dhe vlerësime mbi figurën e tij, duke e paraqitur atë si një burim frymëzimi ndërbrezor. Në kuadër të aktivitetit u shpërndanë gjithashtu kopje të veprës **“Pabesia”**, duke i dhënë pjesëmarrësve mundësinë të njihen më nga afër me krijimtarinë letrare të autorit. U theksua se njohja dhe vlerësimi i figurave si Uran Kostreci nuk përbën thjesht një akt përkujtimor, por një domosdoshmëri shoqërore dhe institucionale për ndërtimin e një shoqërie më të vetëdijshme, më të drejtë dhe më të përgjegjshme ndaj së shkuarës. Në këtë kontekst, aktiviteti kontribuoi në forcimin e kujtesës kolektive dhe në ndërgjegjësimin publik, me qëllim që gabime historike si vendosja e një sistemi shtypës dhe diktatorial në Shqipëri të mos përsëriten më në të ardhmen.



SEKTORI PËR GJETJEN E TË ZHDUKURVE NGA KRIMET E KOMUNIZMIT

-Ky sektor ndjek, monitoron dhe verifikon procesin e kërkimit dhe zhvarrosjes së viktimave të ish të përndjekurve politikë duke bashkëpunuar me institucionet e tjera përgjegjëse.

-Mbledh dëshmi reale nga të mbijetuarit e diktaturës komuniste për ekzekutimet me ose pa gjyq, të vdekur në burgjet e diktaturës, të vrarë në hetuesi ose spitale psikiatrike, të groposur në varre kolektive si dhe të vrarë në kufi në tentativë arratisjeje gjatë periudhës 29/11/1944 – 01/10/1991.

-Akumulon dokumenta arkivore e dëshmi reale, audiovizive dhe materiale të të mbijetuarve nga diktatura.

-Ka krijuar dhe përditëson një database në bazë të kërkesave të paraqitura në institucion mbi të zhdukurit, të ekzekutuarit dhe të vdekurit në burgjet e komunizmit, kampet e internimit dhe qendrat e torturës duke bashkëpunuar për këtë qëllim edhe me institucionet qëndrore dhe lokale.

-Koordinon me organet ligjzbatuese qëndrore dhe lokale, institucionet që kanë arkiva për gjetjen e të zhdukurve.

-Koordinon dhe bashkëpunon me institucione të huaja të specializuara në funksion të marrjes së ndihmës tekniko ligjore për procesin e zhvarrimit dhe identifikimit të kufomave.

-Koordinon në projekte të ndryshme me organizmat dhe donatorë të huaj për procesin e zhvarrimit dhe identifikimit të kufomave.

Që prej fillimit deri në Dhjetor 2025 IIPP nëpërmjet sektorit për gjetjen e të zhdukurve nga krimet e komunizmit punon në drejtim të:

- Mbledhjes së kërkesave pranë IIPP, nga trashëgimtarë e të afërm të personave të zhdukur nga ekzekutimet me ose pa gjyq, të vdekur në burgjet e diktaturës, të vrarë në hetuesi ose spitale psikiatrike, të groposur në varre kolektive si dhe të vrarë në kufi në tentativë arratisjeje gjatë periudhës 29/11/1944 – 01/10/1991.
- Mbledhjes së dëshmive reale nga të mbijetuarit e diktaturës komuniste së bashku me të dhënat e ndryshme që të afërmit kanë marrë në vite për këta persona të zhdukur.
- Kryerjes rregullisht sipas paraqitjes së kërkesave pranë këtij sektori të regjistrimit të kërkesave në databazën e krijuar me të dhënat përkatëse që përmbajnë kerkesat.
- Informimit mbi ecurinë e procesit, personave të interesuar edhe më parë për gjetjen e të afërmve të tyre (të afermit herë pas here paraqiten pranë sektorit për t'u informuar me ecurinë e procesit/ mesatarisht 3-4 herë në vit).
- IIPP çdo vit është bërë pjesë e grupeve të punës kryesisht me Ministrinë e Jashtme mbi kontributin per hartimin dhe pregatitjen e raportit te Shqiperise për zhdukjet e detyruara për të pasqyruar të dhënat, mendimet dhe faktet e trajtuara mbi çështjen e të zhdukurve nga diktatura komuniste në Shqipëri , si dhe ka ofruar kontribute nepermjet ministrise se Brendshme (Drejtoria e Pergjithshme per Migracionin dhe Azilin) per pregatitjen e raportit mbi "Personat e Zhdukur" referuar thirrjes se OHCHR.
- Ka miratuar formatin tip "Kërkesë" për mbledhjen e të dhënave per personat e zhdukur dhe nje formati tip "Deklarate" për përdorimin e të dhënave të paraqitura për palet e treta që ndihmojnë procesin e gjetjes së të zhdukurve. Këto dokumente kane standartizuar

procesin dhe i vijnë në ndihmë moshës së tretë ose personave që kanë nevoje për orientim në dhenien e informacioneve që kanë.

- Pregatitja e nje sërë kërkesave drejtuar institucioneve te ndryshme per bashkepunim mbi zbardhjen dhe qartesimin e fatit te personave te cilet rezultojne te zhdukur nga krimet e komunizmit

Që nga krijimi i sektorit për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit, në Tetor 2014, IIPP filloi të mbledhë informacione dhe raporte përkatëse nga familjet dhe burime të tjera në lidhje me personat e zhdukur nga regjimi komunist. Ka vazhduar regjistrimi i kerkesave nga familjaret. Qe prej fillimit deri në Dhjetor 2025 (rreth 720 kërkesa të referuara nga familjet dhe burime të ndryshme).

Rreth 140 persona referuar periudhes se raportimit, kane ardhur prane sektorit dhe kane perditesuar informacionet e referuara si ndryshimet ne numrat e telefonit, apo informacione te reja qe mund ti sherbejne rastit. 3 raste te reja vetem gjate periudhes Janar-Dhjetor 2025 janë administruar pranë IIPP. Nderkohe rreth 144 raste janë në proces verifikimi.

Megjithate pervec ketij numri, një tjeter numër i caktuar i rasteve është paraqitur edhe tek AIDSSH dhe ICMP. IIPP bashkëpunon me këto institucioneve me qëllim shkëmbimin e të dhenave dhe krijimin e një regjistri te unifikuar. Kjo bazë paraprake e të dhënave është nje hap i parë i cili më tej do të integrohet në një regjistër të mirfilltë me numrin e saktë ose të përafërt të personave të zhdukur në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit.

Ne vijim te perditesimit te te dhenave dhe databases per personat e Zhdukur, IIPP ka bashkepunuar ngushtesisht me Ministrine e Financave, Drejtorine e Demshperblimit dhe Pagesave per te perditesuar te dhenat dhe kontaktet e personave qe mund te jene duke u trajturar me demshperblim. Keto perditesime behen me qellim informimin e familjareve rreth procesit te gjetjes se personave te cilet rezultojne te humbur gjate periudhes se komunizmit. Drejtoria e demshperblimit dhe Pagesave ne Ministrine Finacave ka patur nje komunikim të vazhdueshëm ndërinstitucional verbal ose shkresor, sa i takon bashkëpunimit në vënien në dispozicion të numrave të disa dosjeve individuale të subjekteve “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist”.

IIPP ju ka dërguar në mënyrë periodike, listat me dhe pa numra dosjesh të cilat nuk kanë kontakte. Kryesisht:

-Listën e personave (familjarë apo të afërm) të cilët përfitojnë sipas ligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist", referuar listës bashkëlidhur;

-Listë kontaktesh të familjarëve apo të afërmve.

I eshte bere me dije institucionit se informacioni do të shërbejë vetëm për nevoja të kërkimit dhe identifikimit të këtyre personave të cilët rezultojnë të humbur.

OBJEKTIVAT E SEKTORIT PER VITIN 2025

Gjatë vitit 2025 sektori synoi vazhdin me ndërgjegjesimin dhe sensibilizimin e familjareve ish të përndjekur politik dhe koordinimin ndërinstitucional të cilët kërkojnë qartësimin e fatit të familjarëve të tyre.

- Të përditesohet database e të dhënave për personat e zhdukur nga krimet e komunizmit.
- Te rrisë ndergjegjesimin e komunitetit te ish te perndjekurve politike, familjare apo të aferm për të raportuar personat e zhdukur gjatë regjimit komunist.
- Të sensibiliohet publiku nëpërmjet aktiviteteve përkujtimore mbi qartësimin e fatit të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqiperi.
- Të organizohen takime nëpër rrethe me përfaqësues të shoqatave dhe familjare ish të përndjekur politik për të mbledhur dëshmi reale mbi personat e zhdukur.
- Të analizohen të dhënat për personat e zhdukur dhe të grupohen sipas rastit duke kërkuar informacione shtesë .
- Inspektimin e zonave apo lokacioneve të dyshura për vendvarrime gjatë regjimit komunist për personat e raportuar të zhdukur nga familjaret e tyre.
- Të referohen rastet sipas dinamikes që kanë tek institucionet përgjegjese (prokurori, arkiva, mjeksi ligjore etj) për tu ardhur në ndihme të interesuarve për qartësimin e fatit të familjareve të tyre.
- Bashkëpunon me ministritë e linjës dhe grupet e ngritura ndërinstitucionale për gjetjen dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit.

- Të vazhdojë të krijohen kontakte me organizma kombëtare dhe ndërkombëtare në ndihmë të këtij proçesi.

VENDVARRIME/VARREZA TE MUNDSHME

Sipas statistikave zyrtare, gjatë regjimit diktatorial në Shqipëri janë ekzekutuar 5,548 persona, me ose pa proces gjyqësor, ndërsa trupat e tyre nuk iu dorëzuan familjeve. Po ashtu, 987 individë kanë ndërruar jetë në burgjet e vendit gjatë kësaj periudhe. Këto të dhëna pasqyrojnë përmasat e represionit shtetëror dhe pasojat e tij të thella për familjarët e viktimave. Në bazë të informacioneve të siguruara nga familjet dhe burime të tjera dokumentare, Instituti i Integrimit të ish Perndjekurve Politik (IIPP) ka administruar të dhëna për rreth 79 makro dhe mikro-lokacione të dyshuara si vende të mundshme të fshehjes ose varrosjes së mbetjeve mortore. Aktualisht, këto të dhëna janë duke iu nënshtruar proceseve të verifikimit me qëllim garantimin e saktësisë dhe besueshmërisë së tyre. Deri në këtë fazë, IIPP ka konfirmuar praninë e mbetjeve mortore në të paktën 7 lokacione. Paralelisht, familjarët kanë referuar 22 mikro-lokacione të tjera, të shoqëruara me koordinata të sakta gjeografike, të cilat kërkojnë hetim dhe verifikim të mëtejshëm në terren. Nga dëshmitë e mbledhura dhe dokumentacioni ekzistues, janë identifikuar disa zona që dyshohet se përmbajnë varre masive, përfshirë:

- Hapësirën poshtë ish-kazermës ushtarake në Mirakë, ku mendohet se janë varrosur rreth 34 persona të ekzekutuar pa gjyq;
- Fshatin Krastë në Elbasan;
- Zonën pas murit të varrezave të Rrmajit (varrezat katolike) në Shkodër, ku dyshohet se ndodhen më shumë se 10 persona;
- Fanin e Mirditës;
- Livadhet e Hamzës në Pukë;
- Kthesën e Kaçinarit;
- Kënetën e Maliqit.

Ekzistojnë gjithashtu indicie për vendvarrime të mundshme brenda ose pranë ish-institucioneve të vuajtjes së dënimit të asaj kohe, si:

- Oborret e burgjeve të Spaçit dhe Qafës së Barit;
- Oborri i kishës së Vithkuqit;
- Varreza e burgut të Ballshit (Panahor);
- Oborri i burgut të Burrelit, në vendin e njohur si "te Qershiza";
- Mali i Dajtit, ku dyshohet për një varr masiv të lidhur me ekzekutimet pas ngjarjeve të ambasadës sovjetike.

Shtrirja gjeografike e këtyre lokacioneve, nga jugu në veri të vendit, tregon për një fenomen të përhapur dhe të organizuar të fshehjes së trupave, shpesh në afërsi të kampeve të punës, objekteve ushtarake, burgjeve apo zonave të izoluara natyrore. Në tërësi, informacioni i mbledhur deri më sot nënvizon domosdoshmërinë e vazhdimit të kërkimeve dhe hetimeve të specializuara, me synim zbardhjen e së vërtetës, identifikimin e mbetjeve mortore dhe garantimin e së drejtës së familjeve për drejtësi dhe dinjitet.

NE KUADER TE BASHKEPUNIMEVE
ROLI I ICMP NË KËRKIMIN E VENDVARRIMEVE TË TË ZHDUKURVE NGA KOMUNIZMI

Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), në bashkëpunim me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe institucione të tjera shqiptare, ka ndërmarrë një proces të strukturuar për identifikimin e vendvarrimeve të mundshme të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist (1944–1991). Ky proces është pjesë e një projekti më të gjerë për forcimin e drejtësisë tranzitore dhe përmbushjen e detyrimeve të shtetit shqiptar ndaj rreth 6,000 familjeve që ende nuk dinë fatin e të afërmve të tyre.

Identifikimi i vendndodhjeve të dyshuara

Fillimisht, përmes analizës së dokumenteve arkivore, dëshmive të familjarëve, materialeve hetimore dhe burimeve historike, AIDSSH ka hartuar një listë me rreth 120 vendndodhje të mundshme ku dyshohet se mund të ndodhen varre individuale ose masive të personave të ekzekutuar, vrarë në kufi apo të zhdukur gjatë diktaturës.

Nga kjo listë, në një fazë të parë pilot, ICMP ka kryer sondazhe në 6 lokacione prioritare:

1. Varrezat e Rrmajit (Shkodër)
2. Dy zona në Shpal (Mirditë)

3. Selenicë (Vlorë)
4. Shën Vasil (Himarë)
5. Shelegur (Kolonjë)

Këto zona u përzgjodhën bazuar në indicie të forta dokumentare dhe dëshmi të përsëritura që sugjeronin praninë e varrimeve të fshehura.

Metodologjia e përdorur

- ICMP ka përdorur metoda profesionale dhe shkencore, që përfshijnë:
- Sondazhe arkeologjike paraprake
- Analiza gjeofizike të terrenit
- Vëzhgime antropologjike
- Dokumentim teknik të shtresave të tokës
- Identifikim të strukturave të mundshme të varrimeve

Qëllimi i kësaj faze nuk ka qenë menjëherë zhvarrimi i plotë, por konfirmimi nëse ekzistojnë indikacione të besueshme për praninë e mbetjeve njerëzore dhe nëse vendndodhja justifikon një proces të plotë zhvarrimi forenzik.

Gjetjet paraprake

Sipas rezultateve paraprake të prezantuara institucioneve shqiptare: Në të gjitha 6 vendndodhjet janë konstatuar indikacione për praninë e mbetjeve njerëzore. Disa prej zonave paraqesin karakteristika që përputhen me varrime të fshehta ose jozyrtare. Terrenet në disa raste janë të vështira (zona malore, tokë e paqëndrueshme, ndryshime të mëvonshme të peizazhit), gjë që e bën procesin teknikisht kompleks. Këto gjetje përbëjnë një hap të rëndësishëm, pasi për herë të parë procesi po mbështetet në prova shkencore të verifikueshme.

Hapat e ardhshëm

Vrojtimet përbëjnë vetëm fazën e parë. Për të kaluar në fazën e dytë (zhvarrimin zyrtar dhe analizën forenzike) nevojiten:

- Miratim formal nga Këshilli i Ministrave
- Përfshirja e Prokurorisë
- Koordinim me Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit

- Sigurimi i protokolleve të qarta ligjore dhe të mbrojtjes së provave
- Pas zhvarrimit, mostrat post-mortem do t'i nënshtrohen analizës së ADN-së dhe do të krahasohen me mostrat gjenetike të familjarëve (mostra ante-mortem), të cilat po mblidhen paralelisht në kuadër të projektit.

Vetëm pas këtij procesi mund të bëhet identifikimi shkencor i viktimave.

Rëndësia për familjet dhe për shtetin

Ky proces ka një rëndësi të shumëfishtë: **Humanitare** – u jep familjeve mundësinë të kenë një varr dhe një përgjigje pas dekadash pritjeje; **Ligjore** – ndihmon shtetin të përmbushë detyrimet e tij për zbardhjen e fatit të të zhdukurve; **Historike** – dokumenton krimet e kryera dhe kontribuon në të vërtetën historike; **Shoqërore** – ndihmon në shërimin e traumës ndër breza dhe forcimin e demokracisë. Procesi pritet të shtrihet edhe në lokacione të tjera nga lista prej 120 vendndodhjesh, nëse faza pilot konfirmon efektivitetin e metodologjisë së përdorur.

Në përmbledhje, sondazhet e ICMP përbëjnë hapin e parë konkret dhe shkencor drejt zhvarrimit dhe identifikimit të personave të zhdukur nga komunizmi në Shqipëri — një proces i vështirë, por thelbësor për drejtësi dhe dinjitet.

NDERGJEGJESIM I KOMUNITETIT TE ISH TE PERNDJEKURVE MBI QARTESIMIN E FATIT TE PERSONAVE TE ZHDUKUR NGA KRIMET E KOMUNIZMIT (JANAR-DHJETOR 2025)

Institucioni yne nepermjet fushatave sensibilizuese (televizione, gazeta, webside, takime ndergjegjesuese) u kerkon familjareve te vijne te paraqiten dhe te referojne rastet e tyre. IIPP nepermjet Sektorit per gjetjen e te Zhdukurve perfaqeson gjithe shtresen e ish te perndjekurve te cilet kerkojne te afermit e tyre. Referuar fushes tone te kompetences prane IIPP paraqiten individe, familjare, te aferm te cilet regjistrojne nje kerkese per gjetjen e te afermit te tyre.

Ne cdo rast qe paraqitet informacioni fillimisht perpunohet dhe individi apo familjari ne bashkepunim me IIPP, koordinohet dhe orientohet per te vijuar me proceduren me ICMP, IML, Prokurorine Pergjithshme dhe te rretheve me Arkivat, AIDSSH etj.

Për ndergjegjësimin e qytetarëve në lidhje me procesin e kerkimit te familjareve, gjate periudhes Janar-Dhjetor 2025, IIPP ka zhvilluar një sërë takimesh me komunitetin e ish përndjekurve për të

drejtat e familjeve të të zhdukurve gjatë regjimit komunist në Shqipëri. IIPP eshte angazhuar per te rritur ndergjegjesimin e shoqerise Shqiptare per krimet e komunizmit dhe pasojat qe ka patur per shoqerine me fokus personat e pagjetur te diktatures kryesisht nepermjet aktiviteteve apo takimeve. Gjate takimeve qellimi ka qene rritja e pjesemarrjes se grupeve dhe pjestareve te familjeve te personave te zhdukur, mes te cileve grave ne procesin e drejtesise tranzitore ne Shqiperi. Takimet kane sherbyer per tu ardhur ne ndihme familjareve te personave te zhdukur apo ekzekutuar gjate regjimit komunist 1944-1991, per te njohur me mire te drejtat e tyre dhe per ti ushtruar ato.

Disa nga pyetjet qe jane adresuar gjate takimeve te organizuara me familjaret e personave te zhdukur nga krimet e komunizmit ishin:

1- *Kush konsiderohet person i zhdukur gjate periudhes se komunizmit?*

2- Kush mund te raportoje per nje person te zhdukur?

3- Ku mund te raportohet per gjetjen e nje personi te zhdukur?

Ne takimet e organizuara nje qartesim mbi formatin e kerkesave dhe deklaratave ju jane shperndare te pranishmeve.

Si më poshtë vijon, rendisim disa aktivitete te tjera sensibilizuese të ndërrmarra nga IIPP-ja:

- Ndërgjegjësimin e publikut sa here qe jepet mundesia në mediat e shkruara dhe vizive për personat e zhdukur gjatë krimeve të komunizmit.
- Sensibilizim gjate aktiviteteve te organizuar nga IIPP ne bashkepunim me institucione te tjera apo vetem mbi qartesimin e fatit te ish te perndjekurve politike.
- IIPP ka kryer takime të ndryshme në të gjthë territorin e Republikës së Shqipërisë me familjarët e personave të zhdukur nga krimet e komunizmit si dhe me perfaqesues te OJF-ve të cilat veprojnë në ndihmë të personave ish të dënuar politike.
- Bashkëpunimi në institucionet zyrtare shtetërore si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Dëmshpërblimeve dhe Pagesave ku orientohet target grupi i familjarëve të ish të përndjekurve politikë të paraqiten në zyrat e IIPP dhe të plotësojnë një kërkesë/ deklaratë për familjarët e tyre të zhdukur ***Formulari bashkelidhur Annex 1.***

Këto dokumenta kane standartizuar procesin dhe i vijnë në ndihmë moshës së tretë ose personave që kanë nevoje për orientim në dhenien e informacioneve që kanë pervec kerkeses me shkrim qe ata mund ta depozitojne prane IIPP-se.

AKTIVITETE TE ORGANIZUARA DHE PJESEMARRJE GJATE PERIUDHES JANAR-DHJETOR 2025

Bazuar në misionin e tij, IIPP kontribuon në promovimin e projekteve të kujtesës të cilat përfaqësojnë ish të përndjekurit politik. Gjatë kësaj peridhe nje sere aktivitetesh jane kryer nga IIPP vetem ose në bashkëpunim mbi promovimin, kujtesen dhe qartesimin e fatit te personave te zhdukur gjate periudhes se komunizmit.

- **Simpozium – Shkodër (30 gusht, Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve)**

  Më 28 gusht 2025, në Shkodër, në kuadër të dates 30 Gushti – Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në bashkëpunim me Universitetin "Luigj Gurakuqi", dhe pjesemarrjen e IIPP, organizoi simpoziumin me temë: ***"Kufiri i Shpresës dhe i Vdekjes, 1944–1991. Shkodra përballë së kaluarës."*** Aktiviteti mblodhi përfaqësues të lartë institucionalë, përfshirë Kryetaren e Kuvendit, Ambasadorin e BE-së dhe Kreun e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe deputetë, përfaqësues të institucioneve publike, komuniteteve fetare, familjarë të viktimave dhe të mbijetuar. Në fjalët e tyre, përfaqësuesit theksuan se përballja me të kaluarën është domosdoshmëri për demokracinë, jo hakmarrje, por rikthim dinjiteti për viktimat. U nënvizua nevoja për krijimin e një mekanizmi koordinues institucional për kërkimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve gjatë regjimit komunist, si dhe përshpejtimi i procesit të dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit. Kryetarja e AIDSSH, Znj. Sula, pranoi vonesat në procesin e gjetjes së eshtrave të të zhdukurve, duke theksuar se dokumentacioni arkivor provon se varret janë fshehur qëllimisht nga shteti i kohës. Ajo vuri në pah dimensionin njerëzor të kësaj çështjeje, duke apeluar që përpjekjet të bëhen "për fëmijët tanë" dhe për një Shqipëri që gjen bijtë e saj.

  Gjatë simpoziumit u prezantuan 13 kumtesa shkencore që trajtuan vrasjet në kufi, zhdukjet, terrorin shtetëror, traumën ndërbreznore, rezistencën e grave malësore, arratisjen e intelektualëve dhe mungesën e drejtësisë. U hap gjithashtu një ekspozitë me mbi 6,000 faqe dokumente arkivore që dëshmojnë mekanizmat e kontrollit dhe represionit në

Shkodër. U përkujtuan edhe viktimat e fundit të vrara në kufi në vitin 1990, mes tyre Elez Kraja, Dhurata Sokoli, Vat Beci, Nini Hoti, Pëllumb Pellumbi, Osman Xhakolli dhe 5-vjeçarja Anisa Gruda. Në përfundim, u prezantua projekti artistik për ndërtimin e memorialit "Muri i Gjakut" në Shkodër, si hapësirë reflektimi dhe kujtese për viktimat e komunizmit. Simpoziumi e vendosi Shkodrën në qendër të kujtesës historike, duke përcjellë mesazhin se krimet e së kaluarës nuk duhet të harrohen dhe nuk duhet të përsëriten.

- **Shoqata Kombëtare për Integrimin dhe Rehabilitimin e Ish-të Burgosurve dhe Përndjekurve Politikë të Shqipërisë** – Durrës, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë, realizoi një ekspozitë përkujtimore dhe dokumentuese kushtuar ish-të burgosurve politikë, personave të pushkatuar, individëve të vdekur në institucionet e vuajtjes së dënimit, si dhe ish-të internuarve politikë të qarkut Durrës, viktima të represionit të ushtruar nga regjimi komunist në Shqipëri. Ky aktivitet u konceptua si pjesë e ndërhyrjeve strategjike për ruajtjen, dokumentimin dhe transmetimin e kujtesës historike, duke vlerësuar nevojshmërinë e adresimit të së kaluarës totalitare si një komponent thelbësor i procesit të edukimit qytetar dhe të konsolidimit demokratik. Ekspozita ofroi një qasje gjithëpërfshirëse mbi format e persekutimit politik, duke evidentuar shkeljet sistematike të të drejtave themelore të njeriut dhe pasojat e tyre afatgjata në nivel individual, familjar dhe shoqëror. Përmes përdorimit të materialeve arkivore, dokumenteve historike, dëshmive personale dhe elementeve vizuale, aktiviteti krijoi një hapësirë reflektimi dhe ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, duke kontribuar në forcimin e kulturës së kujtesës dhe të drejtës për të vërtetën. Vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së brezave të rinj, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi pasojat e autoritarizmit dhe rëndësinë e respektimit të vlerave demokratike. Realizimi i ekspozitës shërbeu gjithashtu si një mjet edukues dhe parandalues, duke theksuar domosdoshmërinë që përvoja historike e persekutimit politik të integrohet në diskursin publik dhe në memorien kolektive, me qëllim që praktika të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

  Aktiviteti pati një impakt të matshëm në rritjen e interesit dhe angazhimit të të rinjve në diskutime mbi historinë e afërt dhe përgjegjësinë qytetare, duke kontribuar në ndërtimin e një narrative të qëndrueshme mbi drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin shoqëror.





- U zhvillua në Malësi të Madhe "A***ktiviteti përkujtimor në kuadër të shënimit të 80-vjetorit të Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe",*** një ngjarje e rëndësishme historike e qëndresës ndaj vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Aktiviteti u organizua nga Unioni Mbarëkombëtar për Integrimin e të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të ish Përndjekurve Politikë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave të ish-të përndjekurve politikë, autoriteteve vendore, studiuesve, familjarëve të viktimave dhe qytetarëve. Gjatë aktivitetit u rikujtua se, ndonëse autoritetet komuniste të kohës raportuan vendosjen e kontrollit ushtarak mbi zonën e Shkodrës, në realitet Malësia e Madhe, nga Bajza deri në Vermosh, ishte e organizuar në një qëndresë të gjerë, të udhëhequr nga figura të njohura historike si Prekë Cali, Major Llesh Marashi dhe Mul Deli Bajraktari, së bashku me shumë qëndrestarë të tjerë. U theksua se kryengritja u shtyp me mjete represive nga regjimi komunist, duke sjellë humbje të mëdha njerëzore. Si pasojë e këtij represioni, 112 burra dhe gra humbën jetën, ndërsa dhjetëra të tjerë u ekzekutuan ose u dënuan me burgime dhe internime. Aktiviteti u përmbyll me nderime për martirët dhe qëndrestarët e Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe të vlerave të lirisë dhe demokracisë. Aktivitete të tilla përkujtimore kontribuojnë në ruajtjen dhe transmetimin e kujtesës historike, duke ndihmuar shoqërinë të reflektojë mbi pasojat e regjimeve totalitare dhe rëndësinë e vlerave demokratike.

  Përfshirja e brezave të rinj në këto aktivitete ka një ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e ndërgjegjes qytetare, duke i njohur ata me ngjarje dhe figura historike që kanë mbrojtur lirinë, dinjitetin njerëzor dhe identitetin kombëtar. Këto iniciativa shërbejnë si instrument

edukativ, duke nxitur dialogun ndërbrezor dhe duke forcuar lidhjen e të rinjve me historinë dhe trashëgiminë kombëtare. Në nivel shoqëror, aktiviteti ndihmon në ndërtimin e një kulture kujtese, e cila promovon drejtësinë historike, respektin për viktimat dhe parandalimin e përsëritjes së fenomeneve represive. Përmes dokumentimit dhe përkujtimit institucional, aktivitete të tilla kontribuojnë në konsolidimin e vlerave demokratike dhe shtetit të së drejtës, veçanërisht në edukimin qytetar të brezave të rinj.



- **Tingujt e Kujtesës 2025** ***"Homazh për martirët e Spaçit dhe viktimat e regjimit komunist në Shqipëri".*** Koncerti përkujtimor "Sounds of Memory 2025" u zhvillua në ambientet e ish-kampit të Spaçit, një nga simbolet më të rënda të represionit komunist në Shqipëri. Aktiviteti artistik u organizua për herë të parë në këtë hapësirë historike si një homazh për martirët e Spaçit dhe për të gjitha viktimat e regjimit komunist.Ky aktivitet përkoi me 52-vjetorin e kryengritjes së të burgosurve politikë të Spaçit, e cila përfaqëson aktin e parë dhe të vetëm të rezistencës së organizuar brenda kampeve të internimit dhe burgjeve politike gjatë diktaturës. Koncerti përkujtimor u konceptua si një akt simbolik dhe memorial, duke rikthyer këtë hapësirë të dhunës dhe vuajtjes në një vend reflektimi, nderimi dhe ndërgjegjësimi kolektiv. Përmes gjuhës universale të artit dhe muzikës, aktiviteti synoi të dënojë krimet e regjimit komunist, të nderojë qëndresën dhe sakrificën e të burgosurve politikë, si dhe të kontribuojë në forcimin e kulturës së kujtesës në shoqërinë shqiptare.

- Në aktivitet morën pjesë ish-të burgosur politikë të Spaçit, të përndjekur politikë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, të cilët ritheksuan rëndësinë e përballjes së shoqërisë shqiptare me të kaluarën e saj totalitare si një kusht thelbësor për konsolidimin e demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e një narrative të bazuar në të vërtetën historike. Gjatë koncertit u interpretuan pjesë

muzikore me karakter reflektues dhe përkujtimor, të cilat krijuan një atmosferë nderimi dhe meditimi mbi vuajtjet, sakrificat dhe rezistencën e të përndjekurve politikë. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues institucionesh, ish-të përndjekur, familjarë të viktimave, artistë dhe të rinj. Koncerti shërbeu jo vetëm si një ngjarje kulturore, por edhe si një akt simbolik i rikthimit të jetës dhe zërit në një vend që dikur ishte hapësirë dhimbjeje dhe shtypjeje, duke forcuar mesazhin për ruajtjen e kujtesës historike dhe mos-përsëritjen e krimeve të së kaluarës. Aktiviteti u organizua nga Kujto.al, me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer, Institutit të Integrimit të ish Përndjekurve Politikë, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP). Realizimi i këtij edicioni përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në politikat e kujtesës dhe në proceset e drejtësisë tranzicionale, duke pasur një impakt të ndjeshëm në ndërgjegjësimin e publikut, veçanërisht të brezave të rinj, mbi pasojat e totalitarizmit dhe rëndësinë e ruajtjes së memories historike për të mos lejuar përsëritjen e këtyre krimeve në të ardhmen.





- Unioni Mbarëkombëtar i Ish-të Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe diasporën amerikane të Kelmendit, organizoi në Vermosh të Malësisë së Madhe aktivitetin përkujtimor me rastin e 80-vjetorit të vrasjes së Prekë Calit dhe 13 burrave të tjerë, të ekzekutuar më 25 mars 1945 nga regjimi komunist. Kjo ngjarje historike njihet si Kryengritja e Malësisë së Madhe kundër diktaturës komuniste, një nga aktet më domethënëse të rezistencës antikomuniste në Shqipërinë e pasluftës. Gjatë aktivitetit, historiani dhe profesori Edmond Malaj theksoi se Beteja e Tamarës përfaqëson një moment kyç të luftës civile shqiptare dhe një nga episodet më të dhimbshme të historisë sonë

kombëtare. Ai vlerësoi figurën e Prekë Calit si një nga personalitetet më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke nënvizuar rolin e tij në mbrojtje të identitetit, lirisë dhe dinjitetit kombëtar. Prekë Cali u pushkatua më 25 mars 1945, pas një dënimi me vdekje nga regjimi komunist, ndërsa popullsia e Malësisë së Madhe u përball për dekada me radhë me represion të vazhdueshëm, përfshirë vrasje, tortura dhe dënime të rënda që zgjatën për rreth 45 vite. Aktiviteti përkujtimor vijoi me një program artistik, ku morën pjesë artistë të zonës së Malësisë së Madhe, duke i dhënë aktivitetit një dimension kulturor dhe simbolik, në funksion të ruajtjes së kujtesës historike dhe përcjelljes së saj tek brezat e rinj.



- Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Integrimit të Ish-Përndjekurve Politikë (IIPP), organizoi në qytetin e Tropojës, një aktivitet përkujtimor në nderim të viktimave të diktaturës komuniste. Ky aktivitet u zhvillua në një trevë me histori të spikatur qëndrese, për t'u përulur me respekt të thellë përpara kujtimit të atyre që u vranë, u burgosën, u dëbuan dhe u internuan nga regjimi komunist, por që nuk u nënshtruan kurrë në shpirt dhe në ndërgjegje. Në këtë ditë u përkujtuan me dhimbje dhe krenari Fet Sadiku dhe Uke Quni, dy martirë të pushkatuar pa gjyq më 29 shtator 1946 në Lekbibaj, në prani të rreth 2000 burrave, vetëm për faktin se mbetën të lirë në mendim dhe në shpirt. Përmes figurës së tyre u nderuan edhe 1121 të përndjekur dhe të sakrifikuar deri në vdekje, nga Qafa e Agrit deri në Qafë Morinë, duke përfaqësuar simbolikisht të gjitha viktimat e Malësisë së Gjakovës.

Bilanci i persekutimit në këtë trevë përfshin: 198 persona të pushkatuar, shumë prej tyre pa asnjë proces gjyqësor; qindra të burgosur politikë, të dënuar në kushtet çnjerëzore të burgjeve të diktaturës; qindra familje të internuara dhe të dëbuara, me shumë viktima që humbën jetën

në kampet e përqendrimit dhe të punës së detyruar, duke jetuar për vite me radhë në kushte përjashtimi, harrese dhe përçmimi.

- Malësia e Gjakovës ka mbajtur mbi supe një nga barrët më të rënda të persekutimit politik në Shqipëri dhe, pavarësisht kësaj, nuk ka kërkuar asgjë tjetër përveç drejtësisë, njohjes dhe së vërtetës historike. Ruajtja e kësaj kujtese përbën një detyrim moral dhe kombëtar ndaj viktimave dhe një domosdoshmëri për ndërgjegjen demokratike të shoqërisë shqiptare.





- **ICMP përfundon vrojtimin në 6 vendvarrimet e dyshuara të dala nga hetimet e AIDSSH-SË**

Ky takim u zhvillua në kuadër të projektit ***"Mbështetja e drejtësisë tranzitore dhe përballja me të shkuarën në Shqipëri"***, me qëllim prezentimin e gjetjeve të ekspeditave të para në 6 vendvarrime të dyshuara nga periudha komuniste me 24 Shtator 2024, Tiranë. Vrojtimet përfshinin **6 vendvarrime të dyshuara** nga lista prej rreth 120 vendndodhjesh të identifikuara: Varrezat e Rrmajit (Shkodër), dy vendvarrime në Shpal (Mirditë), një në Selenicë (Vlorë), një në Shën Vasil (Himarë) dhe një në Shelegur (Kolonjë). Këto vendndodhje u përzgjodhën bazuar në analizën e dokumenteve të institucioneve, familjarëve dhe të komuniteteve, si dhe nga investigime paraprake të AIDSSH. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, pushtetit vendor, Prokurorisë, Policisë së Shtetit, organizatave të të përndjekurve dhe familjarëve të viktimave. Kryetarja e AIDSSH, Znj. Sula, vlerësoi bashkëpunimin me ICMP dhe Bashkimin Evropian dhe theksoi rëndësinë e këtij procesi për gjetjen e eshtrave dhe përmbushjen e kërkesave të familjeve që kanë aplikuar për informacion.

Përfaqësuesit e ICMP, Luigj Ndou dhe Sandra Sostaric, prezantuan veprimet e kryera në terren, sfidat dhe kompleksitetin e vendeve (terrene të vështira, probleme pronësie, rrjedha uji, struktura të ndërtuara afër vendvarrimeve) dhe dhanë rekomandime për ndërhyrje të mëtejshme. U theksua

se ky proces lidhet ngushtë me kujtesën kolektive dhe drejtësinë tranzicionale dhe se do të vazhdojë me gërmime të specializuara, analizë ADN-je dhe verifikim dokumentar, duke u zgjeruar edhe në vendvarrime të tjera të dyshuara.

HAPAT E PROCESIT TE VROJTIMIT

Mbledhja e informacionit paraprak: Intervista me familjarët dhe personat që kishin dijeni për zhdukjet; Analizimi i dokumenteve arkivore dhe urdhrave të periudhës komuniste; Kryqëzimi i të dhënave për të identifikuar vendvarrime me probabilitet të lartë.

Vlerësimi i terrenit:]Vizita në terren dhe fotografim nga afër; Identifikimi i vështirësive fizike: toka e thyer, rrëshqitje, rrjedha uji, prani e strukturave të ndërtuara pranë vendvarrimeve.

Ekspeditat arkeologjike: Kryerja e ekspeditave të parapara për të identifikuar indicie të eshtrave ose varrimeve të fshehta; Analiza gjeofizike e tokës për të zbuluar struktura të fshehura.

Rekomandimet për ndërhyrje të mëtejshme:

- Identifikimi i mënyrës më të përshtatshme për gërmimin, duke marrë parasysh pronësinë e tokës, karakteristikat e terrenit dhe urgjencën për shkak të rrezikut nga rrjedhat e ujit apo rrëshqitjet.
- Administrimi i gjetjeve gjatë analizave forenzike.
- Përgatitja e protokolleve për analizë ADN dhe krahasim me mostrat gjenetike të familjarëve.

Bashkëpunimi institucional

- Takimi nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit mes:
- AIDSSH (Autoriteti për Dosjet)
- ICMP (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur)
- Institutit të Ish të Përndjekurve Politikë
- Policisë së Shtetit
- Prokurorisë së Përgjithshme
- Pushtetit vendor

Ky bashkëpunim është i domosdoshëm për t'u siguruar familjarëve informacion të saktë, për t'u zbatuar procedurat ligjore dhe për të mbrojtur integritetin e provave gjatë gërmimeve dhe analizave.

Sfida dhe ndjeshmëri

Procesi i kërkimit të eshtrave është:

- Teknikisht kompleks: terrenet e vështira, struktura të ndërtuara, rrëshqitje toke.
- Ligjërisht delikat: kërkon miratimin e Këshillit të Ministrave dhe koordinim mes institucioneve.
- Humanisht dhe historikisht i ndjeshëm: lidhet me kujtesën kolektive, drejtësinë tranzicionale dhe dhimbjen e familjarëve.

Hapat e ardhshëm

- Shtrirja e ekspeditave dhe gërmimeve edhe në vendvarrime të tjera të dyshuara.
- Kryerja e gërmimeve të specializuara dhe marrja e mostrave post-mortem.
- Analiza e ADN-së dhe krahasimi me mostrat gjenetike të familjarëve.
- Përgatitja e raporteve finale për identifikimin e viktimave dhe njoftimi i familjarëve.

Ky aktivitet shënon fazën fillestare të një procesi afatgjatë, që ka si qëllim të sigurojë drejtësi për të zhdukurit, t'u japë familjarëve një përgjigje dhe të dokumentojë historinë e krimeve të komunizmit në Shqipëri. Në thelb, takimi shërbeu për **prezantimin e hapat e parë shkencorë dhe logjistikë**, diskutimin e sfidave dhe planifikimin e fazave të ardhshme për identifikimin e të zhdukurve nga regjimi komunist, me synimin për t'u dhënë përgjigje familjarëve dhe shoqërisë.

PUNË TË TJERA SIPAS NEVOJËS SË INSTITUCIONIT

Sektori eshte angazhuar në grupe pune te ndryshme si ç mund te permendim, perfaqesues ne komisione mbi prokurimet, inventarizimet, ndihmat sociale etj.

SFIDAT KRYESORE TE HASURA GJATE KRYERJES SE PROCESIT PER IDENTIFIKIMIN DHE GJETJEN E PERSONAVE TE CILET REZULTOJNE TE ZHDUKUR NGA KRIMET E KOMUNIZMIT

Sektori raporton cdo jave tek titullari mbi problematikat veshtiresite e hasura gjate kryerjes se detyrave. Punohet ne ekip per analizimin e situatave, krijimin e planeve te punes dhe ecurine e procesit.

- Mungesa e nje informacioni me te detajuar për vendvarrimet e pretenduara. Ku si sfidë tjetër është migrimi i familjarëve dhe mungesa e informacionit të kontaktit.
- Mungesa e burimeve dhe kapaciteteve teknike per trajtuar këtë çështje të rëndësishme dhe sfiduese. Ne po bëjmë përpjekje që kjo çështje të adresohet në rrugë institucionale.

REFERUAR FUSHËS SE KOMPETENCES SE SEKTORIT, PLANI NË VAZHDIM PËR VITIN 2025 PËR PROÇESIN E GJETJES SË TË ZHDUKURVE GJATË REGJIMIT KOMUNIST ËSHTË I FOKUSUAR NË:

- IIPP vazhdon me shkëmbimin e të dhënave relevante me institucione të ndryshme si AIDSSH dhe institucione ndërkombëtare si ICMP të cilat mund të ndihmojnë në procesin e identifikimit dhe gjetjes së të zhdukurve. Vlerësimi i nevojave për zhvarrim, rikuperim dhe identifikim të personave të zhdukur; Nga ana administrative duhet: Forcimi i kapaciteteve hetimore dhe ligjore, përfshirë mbrojtjen e të dhënave; Trajnime dhe mentorim për stafin përkatës; Mbledhja e të dhënave para vdekjes (ante-mortem) dhe mostrave gjenetike nga familjarët; Testimi i ADN-së nga mostrat e marra nga eshtrat (post-mortem) dhe krahasimi me ADN-në e familjarëve. Bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet e përfshira gjatë kohës së diktaturës komuniste dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm në proçesin e gjetjes dhe qartesimin e fatit te familjareve te cilet rezultojne te humbur qe nga periudha komuniste.
- Zgjerimin e databases me të dhenat e personave te konsideruar të humbur nga familjaret e tyre; Krijimi i regjistrave me të dhëna për personat e zhdukur dhe vendndodhjet e varreve; Instituti vazhdon me pranimin e kërkesavë të ndryshme nga familjarët dhe të afërmit për gjetjen e të zhdukurve nga krimet e komunizmit dhe po vazhdon me fushatën sensibilizuese në mediat lokale dhe ndërkombëtare.

- Sensibilizimin e vazhdueshem të afërmve të viktimave dhe të gjithë të interesuarve në të gjithë rrethet e vendit për procesin e mbledhjes së informacionit për personat e zhdukur nga regjimi komunist.
- Hartëzimin e vendeve potenciale të konsideruara si varre masive; hapjen e investigimeve për ato varre masive të cilat janë identifikuar tashmë;
- Punë e vazhdueshme për krijimin e kontakteve me organizma kombëtare dhe ndërkombëtare në ndihmë të këtij proçesi.

Shkresa të ndryshme ndaj institucioneve apo individëve të cilët referojnë persona të cilët rezultojnë të humbur osë të zhdukur. Sipas IIPP, me shumë rëndësi mbetet krijimi i një strategjie e cila do të përfshinte të gjithë aktorët dhe institucionet përgjegjëse në respektim të të drejtave të njeriut për personat e humbur gjatë kësaj periudhe. Mirëkoordinimi dhe bashkëpunimi i institucioneve me fokus në këte fushë mbetet sfida kryesore. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm për familjet e prekura drejtpërdrejtë, por edhe për shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Krahas kthimit të dinjitetit të viktimave dhe familjeve të tyre, identifikimi i këtyre personave është i rëndësishëm edhe për kujtesën kolektive, parandalimin e përsëritjes dhe përfundimin e tranzicionit të zgjatur shqiptar.

Përfundim

Gjatë këtij viti, veprimtaria e Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë ka konfirmuar rëndësinë kyçe të sektorit social dhe të mbështetjes komunitare për këtë kategori. Përmes projekteve të koordinuara, bashkëpunimit me shoqata dhe institucione të linjës, si dhe përpjekjeve për integrimin socio-ekonomik dhe kulturor, Instituti ka arritur të forcojë dinjitetin, të drejtat dhe përfaqësimin e ish-të përndjekurve politikë. Aktivitetet e zhvilluara kanë pasur një impakt të drejtpërdrejtë në jetën e përfituesve, duke përmirësuar kushtet e jetesës, ofruar mundësi për punësim dhe zhvillim profesional, si dhe krijuar hapësira për ruajtjen e kujtesës historike dhe trashëgimisë kulturore.

Realizimi i objektivave të përcaktuara për këtë vit tregon një angazhim të qëndrueshëm dhe efektiv të IIPP-së, duke demonstruar kapacitetin e institucionit për të identifikuar nevojat emergjente të ish-të përndjekurve, për t'iu përgjigjur atyre në mënyrë të koordinuar dhe për të siguruar mbështetje të qëndrueshme. Bashkëpunimi me shoqatat, institucionet publike dhe partnerët komunitarë ka mundësuar jo vetëm realizimin e aktiviteteve të planifikuara, por edhe rritjen e pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e kujtesës historike dhe të drejtave të kësaj kategorie.

Krahas dimensionit social, veprimtaria e Institutit është mbështetur fuqishëm edhe në një qasje të konsoliduar ligjore. Përmes zbatimit korrekt të legjislacionit në fuqi, ofrimit të konsulencës juridike, përfaqësimit në procese gjyqësore dhe ndjekjes së procedurave administrative, është

garantuar mbrojtja e të drejtave të ish-të përndjekurve politikë dhe trajtimi i kërkesave të tyre në përputhje me standardet ligjore. Kjo qasje ka siguruar transparencë, barazi para ligjit dhe respektim të plotë të procedurave në çdo rast të shqyrtuar.

Njëkohësisht, Instituti ka demonstruar mirëmenaxhim financiar, duke administruar fondet publike me efikasitet dhe eficencë në funksion të përfituesve. Planifikimi i kujdesshëm i shpenzimeve, ndjekja e procedurave të prokurimit sipas legjislacionit në fuqi dhe monitorimi i vazhdueshëm i përdorimit të fondeve kanë garantuar përdorimin racional të burimeve financiare, duke maksimizuar ndikimin e tyre në mbështetje të shtresës së ish-të përndjekurve politikë. Kjo ka mundësuar realizimin e objektivave të parashikuara, duke ruajtur standardet e larta të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies institucionale.

Në përfundim, veprimtaria e këtij institucioni është dëshmi e qartë e ndikimit pozitiv që ka një qasje gjithëpërfshirëse, sociale, ligjore dhe integruese. Ajo tregon se mbështetja institucionale dhe komunitare ndaj ish-të përndjekurve politikë nuk është vetëm një detyrim moral dhe historik, por edhe një investim afatgjatë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, solidare dhe të vetëdijshme për historinë dhe përgjegjësitë e saj.